



ГЛАСИЛО GAZETË



Ноември 2025
Nëntor 2025

**ЗЕЛС
ЗАЕДНИЦА НА
ЕДИНИЦИТЕ
НА ЛОКАЛНАТА
САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА
СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА**

**BNJVL
BASHKËSIA E
NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES
LOKALE TË
REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË
VERIUT**



**КРАТКИ БИОГРАФИИ НА ГРАДОНАЧАЛНИЦИТЕ
ЗА МАНДАТОТ 2025-2029 ГОДИНА**

**BIOGRAFI TË SHKURTËRA TË KRYETARËVE TË
KOMUNAVE PËR MANDATIN E VITEVE 2025-2029**



Почитувани,

Од името на ЗЕЛС, на сите градоначалници и на сите советници, избрани на локалните избори одржани во октомври и ноември оваа 2025 година, ви ја честитам победата и ви посакувам успешно спроведување на надлежностите. Довербата што ја добивте од граѓаните, сигурна сум дека ќе ви биде силен поттик да ги реализирате најавените проекти, во насока на создавање поквалитетни услуги и подобар живот за жителите на општините. По секој изборен циклус, стручната служба на ЗЕЛС подготвува „Прирачник, водич низ надлежностите за новоизбраните градоначалници и членовите на советите на општините“. Тоа го сторивме и во овој изборен циклус и ви го испративме по електронски пат. Прирачникот најмногу ќе ви служи на оние што за првпат се соочуваат со дадената функција, но и на останатите, бидејќи ќе ви овозможи на најбрз начин да се запознаете со надлежностите на локалната власт, финансирањето, законските обврски и многу други важни работи од вашето работење.

Како и досега така и во иднина, ЗЕЛС ќе продолжи со континуираната поддршка подеднакво на сите општини, со реализирањето на зацртаните стратемиските цели и со заложбите за исполнување на СИСТЕМАТИЗИРАНИТЕ СТАВОВИ на ЗЕЛС. Лобирањето за решавање на бројните предизвици со кои се соочуваат единиците на локалната самоуправа, обезбедувањето на поквалитетни законски решенија, продлабочувањето на процесот на децентрализација и обезбедувањето на поголема финансиска стабилност се од приоритетно значење на ЗЕЛС. Но исто така, ЗЕЛС ќе продолжи и со активностите на континуирано јакнење на капацитетите на општинската администрација, како и со поддршка на општините во спроведувањето на постојните, но и на нови електронски услуги за граѓаните.

Во овој број на Гласило на ЗЕЛС, како своевидно специјално издание што го правиме традиционално по завршувањето на секој циклус на локални избори, ги објавуваме кратките биографии на сите градоначалници и на четворицата повереници избрани од Владата на РСМ. Биографиите и фотографиите на градоначалниците, како и контактите од советниците ги добивме електронски од сите општини и ни служат за обновување на базата на податоци на ЗЕЛС за натамошна континуирана заедна комуникација.

ЗЕЛС се покажа и докажа како значајна организација во земјава, но и во странство, а една од нејзините најсилни алатки за постигнатите успеси е градењето и одржувањето на единството на сите нејзини членки. Затоа и во иднина, како една од приоритетните заложби треба да ни биде одржувањето на ова единство, но и негово издигнување на уште повисоко ниво.

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Тë nderuar,

Në emër të BNJVL-së, uroj të gjithë kryetarët e komunave dhe të gjithë këshilltarët e zgjedhur në zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor dhe nëntor 2025 për fitoren e tyre, duke u dëshiruar zbatim të suksesshëm të kompetencave të tyre. Jam e sigurt se besimin që keni marrë nga qytetarët do të jetë nxitje e fortë për ju për të zbatuar projektet e paralajmëruara në drejtim të krijimit të shërbimeve më cilësore dhe një jetë më të mirë për banorët e komunave. Pas çdo cikli zgjedhor, shërbimi profesional i BNJVL-së përgatit një “Doracak, udhëzues për kompetencat e kryetarëve të komunave dhe anëtarët e sapozgjedhur të këshillave komunale”. Ne e bëmë këtë edhe në këtë cikël zgjedhor dhe jua dërguam në formë elektronike. Doracaku do të jetë shumë i dobishëm për ata që përballen me këtë funksion për herë të parë, por edhe për të tjerët, sepse do t’ju mundësojë të njiheni në mënyrë më të shpejtë me kompetencat e qeverisjes lokale, financimin, detyrimet ligjore dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme të punës suaj.

Si deri më tani, ashtu edhe në të ardhmen, BNJVL do të vazhdojë me mbështetjen e saj të vazhdueshme, në mënyrë të barabartë për të gjitha komunat, me realizimin e qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe me përpjekjet për përmbushjen e QËNDRIMEVE TË SISTEMATIZUARA të BNJVL-së. Lobimi për zgjidhjen e sfidave të shumta me të cilat përballen njësitë e vetëqeverisjes lokale, sigurimi i zgjidhjeve më cilësore ligjore, thellimi i procesit të decentralizimit dhe sigurimi i stabilitetit më të madh financiar janë me rëndësi prioritare për BNJVL-në. Por gjithashtu, BNJVL do të vazhdojë me aktivitetet e forcimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të administratës komunale, si dhe me mbështetjen e komunave në zbatimin e shërbimeve ekzistuese, por edhe atyre të reja elektronike për qytetarët.

Në këtë numër të Gazetës së BNJVL-së, si një lloj botimi special, të cilin tradicionalisht e përgatisim pas përfundimit të çdo cikli të zgjedhjeve lokale, publikojmë biografitë e shkurtra të të gjithë kryetarëve të komunave dhe katër të besuarve të zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ne siguroam biografitë dhe fotot e kryetarëve të komunave, si dhe kontaktet e këshilltarëve në mënyrë elektronike nga të gjitha komunat dhe ato na shërbejnë për të azhurnuar bazën e të dhënave të BNJVL-së për komunikim të mëtejshëm të vazhdueshëm të ndërsjellë.

BNJVL-ja e ka treguar dhe e ka dëshmuar veten si një organizatë e rëndësishme në vend, por edhe jashtë vendit, dhe një nga mjetet e saj më të forta për sukseset e arritura është ndërtimi dhe ruajtja e unitetit të të gjithë anëtarëve të saj. Prandaj, në të ardhmen, si një nga zotimet prioritare duhet të jetë ruajtja e këtij uniteti, por edhe ngritja e tij në një nivel edhe më të lartë.

Me respekt,

Dushica Perishiq,
Drejtoreshë ekzekutive e BNJVL-së

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

тел. +389 (0) 2 30 99 033

ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,

1000 Скопје, Република Северна Македонија

Извршен директор на ЗЕЛС:

Душица Перишиќ

Заменик извршен директор на ЗЕЛС:

Ардита Дема Мехмети

Подготвила: Весна Арсовска-Динковска

Превод: Славе Чорbev

Лекторирал: Валентина Великова

Дизајн и подготовка: Никола Тодоровски, Карина Донеvска

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

tel. +389 (0) 2 30 99 033

rr. Kopenhagenska nr. 5, F.P. 32,

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:

Dushica Perishiq

Zëvendës drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:

Ardita Dema Mehmeti

Përgatiti: Vesna Arsovska-Dinkovska

Përkthim: Sllave Çorbev

Lektoron: Valentina Velikova

Dizajnim dhe përgatitje: Nikola Todorovski, Karina Donevska

Општина АЕРОДРОМ

Градоначалник: ДЕЈАН МИТЕСКИ

Дејан Митески е роден на 20 јуни 1987 година во Скопје. Дипломирал на Правниот факултет при УКИМ во Скопје, во 2009 година, а во 2016 година се стекнал со магистерска диплома на Универзитетот „Американ колеџ“, во Скопје. Во април 2018 година го положил правосудниот испит. Своео практично знаење во областа на правото го надградувал во повеќе државни институции, меѓу кои: Министерството за транспорт и врски; владината второстепена комисија од областа на имотноправни работи и градежно земјиште; во Дирекцијата за технолошки индустриски развојни зони како член на Управниот одбор, бил член во Советодавниот комитет за земјишна политика како дел од проектот „Катастар на недвижности и регистрација“ и бил член на Комисијата за организирање, спроведување обука и испит за стекнување со овластување за располагање со градежно земјиште. Тој е коавтор на Законот за градежно земјиште (2015), коавтор на повеќе законски измени на Законот за просторно и урбанистичко планирање и на Законот за градење, како и на повеќе подзаконски акти кои произлегуваат од овие два закона. Учествовал и при имплементација на европските регулативи во домашното законодавство. Во периодот 2013 – 2017 година бил член на Советот на Општина Аеродром, а потоа во мандатот 2021 – 2024 бил избран за претседател на Советот. На 28 јуни 2024 година, официјално ја презел функцијата заменик-градоначалник, а потоа на 15 јули, истата година, Советот го изгласал за вршител на должноста градоначалник на Општина Аеродром.



Komuna e AERODROMIT

Kryetar: DEJAN MITESKI

Dejan Miteski është lindur më 20 qershor 1987 në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në vitin 2009, ndërsa në vitin 2016 ka fituar diplomën e masterit në Universitetin “American College” në Shkup. Në prill të vitit 2018 ka kaluar provimin e jurisprudencës. Njohuritë e tij praktike në fushën e drejtësisë i ka përmirësuar në disa institucione shtetërore, ndër të cilat: Ministria e Transportit dhe Lidhjeve; Komisioni qeveritar i shkallës së dytë në fushën e çështjeve pronësore juridike dhe tokës ndërtimore; në Drejtorinë për Zhvillimin e Zonave Industriale Teknologjike si anëtar i Bordit Drejtues, ka qenë anëtar në Komitetin Këshillëdhënës për Politikën e Tokës si pjesë e projektit “Kadastra e Pasurive të Paluajtshme dhe Regjistrimi” dhe ka qenë anëtar i Komisionit për organizimin, zbatimin e trajnimeve dhe provimeve për marrjen e autorizimit për menaxhimin e tokës ndërtimore. Ai është bashkautor i Ligjit për tokën ndërtimore (2015), bashkautor i më shumë ndryshimeve ligjore të Ligjit për planifikimin hapësinor dhe urbanistik dhe të Ligjit për ndërtim, si dhe i disa akteve nënligjore që rrjedhin nga këto dy ligje. Ka marrë pjesë edhe në implementimin e rregulloreve evropiane në legjislacionin e brendshëm. Në periudhën e viteve 2013 - 2017 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës Aerodrom, ndërsa më pas në mandatin 2021 - 2024 u zgjodh president i Këshillit. Më 28 qershor 2024, zyrtarisht mori detyrën e zëvendës-kryetarit të komunës, ndërsa më pas më 15 korrik, të njëjtut vit, Këshilli e zgjodhi për ushtrues detyre të kryetarit të Komunës Aerodrom.

Општина АРАЧИНОВО

Градоначалник: ДАУТ БЕКИРИ

Даут Бекири е роден на 22 ноември 1988 година во Арачиново. Завршил гимназија, а потоа со високо образование се стекнал на Факултетот за криминалистика, насока Детективи и безбедност. Бил сопственик и менаџер на семејна фирма во секторот за производство на мебел. Покрај професионалниот ангажман, тесно е поврзан со општествениот живот на заедницата и придонесувал како советник во џамијата Мираџ и е дел од Советот за помирување во заедницата. Добро зборува англиски јазик. Член е на раководството на ФК „Шкендија 77“. Познат е и по иницирање на хуманитарни акции и поддршка на граѓаните на кои им е потребна помош.



Komuna e HARAÇINËS

Kryetar: DAUT BEQIRI

Daut Beqiri është lindur më 22 nëntor 1988 në Haračinë. Ka mbaruar gjimnazin, ndërsa më pas ka mbaruar arsim të lartë në Fakultetin e Kriminalistikës, drejtimin detektivë dhe siguri. Ka qenë pronar dhe menaxher i një firme familjare në sektorin e prodhimit të mobilieve. Përveç angazhimit profesional, është i lidhur ngushtë me jetën shoqërore të komunitetit dhe ka kontribuar si këshilltar në xhaminë Miraxh dhe është pjesë e këshillit për pajtim në komunitet. Flet mirë gjuhën angleze dhe është anëtar i udhëheqjes së KF Shkëndija 77. Është i njohur edhe për iniciativat humanitare dhe mbështetje të qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë.

Општина БЕРОВО

Градоначалник: ПЕТАР РУЖИНСКИ

Петар Ружински е роден на 5 мај 1976 година во Скопје. Основно и средно образование завршил во Берово, а потоа дипломирал на Правниот факултет во Скопје. Тој бил долгогодишен ментор и едукатор во областа на неформалното образование и има повеќе од 20 години активно искуство во работа со ученици по математика. Активно соработувал со невладини институции во развојот и имплементацијата на различни програми и проекти. Посветен е на својата мисија — преку знаење, поддршка и инспирација, да го поттикне секој млад човек, да го достигне својот полн потенцијал. Зборува англиски, српски, бугарски и хрватски. Читањето книги, спортувањето и патувањето се активности што ги прави со задоволство во слободното време. Не е оженет. Во периодот од 2021 до 2025 година бил член на Советот на Општина Берово, а во 2024 година бил избран и за претседател на ова тело.



Komuna e BEROVËS

Kryetar: PETAR RUZHINSKI

Petar Ruzhinski është lindur më 5 maj 1976 në Shkup. Arsimitin fillor dhe atë të mesëm e ka mbaruar në Berovë, ndërsa më pas ka diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Shkup. Ai ka qenë mentor dhe edukator për shumë vite në fushën e arsimit joformal dhe ka më shumë se 20 vjet përvojë aktive në punën me nxënësit e matematikës. Ka bashkëpunuar aktivisht me institucione joqeveritare në zhvillimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme. Ai është i përkushtuar ndaj misionit të tij - përmes njohurive, mbështetjes dhe frymëzimit, të inkurajojë çdo njeri të ri që të arrijë potencialin e tij të plotë. Flet anglisht, serbisht, bullgarisht dhe kroatisht. Leximi i librave, merrja me sport dhe udhëtimi janë aktivitete që i bën me kënaqësi në kohën e tij të lirë. Nuk është i martuar. Në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2025 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Berovës, ndërsa në vitin 2024 është zgjedhur gjithashtu president i këtij trupi.

Општина БОГДАНЦИ

Градоначалник: БЛАЖЕ ШАПОВ

Блаже Шапов е роден на 6 декември 1977 година во Гевгелија. Во континуитет живее во Општина Богданци, освен во периодот на средното и високото образование. Дипломирал во 2005 година на Факултетот за физичка култура при УКИМ, Скопје. До 2017 година работел како професор по физичко воспитување во СОУ „Богданци“ од Богданци. Тој е истакнат спортски работник, поранешен фудбалер и тренер на ФК „Вардарски“ Богданци, поранешен претседател на СРД „Костреш“ Богданци. Се занимава рекреативно со риболов. Зборува англиски јазик. Женет е и татко на две деца. Бил член на Советот на Општина Богданци во периодот 2009 – 2013 година, а следниот мандат бил и претседател на ова тело. На локалните избори во 2025 година, последователно, по третпат, жителите му ја довериле функцијата градоначалник на Општина Богданци.



Komuna e BOGDANCIT

Kryetar: BLLAZHE SHAPOV

Blazhe Shapov është lindur më 6 dhjetor 1977 në Gjevgjeli. Ai jeton vazhdimisht në Komunën e Bogdancit, përveç në periudhën e arsimit të mesëm dhe të lartë. Ka diplomuar në vitin 2005 në Fakultetin e Kulturës Fizike pranë “Universitetit Shën Kirilit dhe Metodit”, Shkup. Deri në vitin 2017 ka punuar si profesor i edukatës fizike në SHMK “Bogdançi” nga Bogdanci. Ai është një punonjës i njohur sportiv, ish-futbollist dhe trajner i KF “Vardarski” Bogdanci, ish-president i SHRS “Kostresh” Bogdanci. Merret me peshkim në mënyrë rekreative. Flet gjuhën angleze. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Bogdancit në periudhën e viteve 2009 – 2013, ndërsa në mandatin vijues ka qenë edhe president i këtij trupi. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, banorët ia besuan funksionin e kryetarit të Komunës së Bogdancit për herë të tretë radhazi.

Општина БИТОЛА

Градоначалник: ТОНИ КОЊАНОВСКИ

Тони Коњановски е роден на 28 јануари 1962 година во Битола. Високото образование го започнал на Медицинскиот факултет во Белград, а го продолжил на Медицинскиот факултет при УКИМ во Скопје, каде што и дипломирал. Во 1992 година ја започнал кариерата во ЈЗУ Здравствен дом во Ресен, како лекар во Службата за итна медицинска помош и домашно лекување, каде што бил и директор во периодот 1997 – 2000 година. Од 2000 година се вработил во тогашниот Завод за здравствена заштита. Истата, 2000 година ја започнал специјализацијата по епидемиологија на Институтот за епидемиологија, при Медицинскиот факултет во Скопје. По специјализирањето, раководел со Отсекот за дезинфекција, дезинсекција и дератизација во составот на Одделението за епидемиологија при ЈЗУ 333 Битола, каде што бил директор во периодот од октомври 2016 до август 2017 година. Во 2014 година се стекнал со стручно звање примариус. Бил претседател на Здружението на епидемиолози. Членува во повеќе комисии, работни групи и здруженија од областа на епидемиологијата, хигиената и заштитата на животната средина, безбедност на храната и контрола на интрахоспитални инфекции и друго. Зборува англиски јазик. Оженет е и има две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, населението му ја дало довербата да ја извршува функцијата градоначалник на Општина Битола.



Komuna e MANASTIRIT

Kryetar: TONI KONJANOVSKI

Toni Konjanovski është lindur më 28 janar 1962 në Manastir. Arsimin e lartë e ka filluar në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd dhe ka vazhduar në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku ka diplomuar. Në vitin 1992 ka filluar karrierën në ISHP Shtëpia e Shëndetit në Resnjë, ku ka qenë mjek në Shërbimin e ndihmës urgjente mjekësore dhe shërimit shtëpiak, ku ka qenë edhe drejtor në periudhën prej vitit 1997 deri në vitin 2000. Në vitin 2000 u punësua në Entin e atëhershëm e Mbrojtjes Shëndetësore. Në të njëjtin vit 2000 ka filluar specializimin e epidemiologjisë në Institutin e Epidemiologjisë pranë Fakultetit të Mjekësisë në Shkup. Pas specializimit ka drejtuar Departamentin për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim në kuadër të Departamentit të Epidemiologjisë në IPSH Enti për Mbrojtje Shëndetësore, Manastir, ku ka qenë drejtor në periudhën nga tetori i vitit 2016 deri në gusht të vitit 2017. Në vitin 2014 ka marrë titullin profesional primarius. Ka qenë kryetar i Shoqatës së Epidemiologëve. Është anëtar i disa komisioneve, grupeve punuese dhe shoqatave në fushën e epidemiologjisë, higijenës dhe mbrojtjes së mjedisit, sigurisë së ushqimit dhe kontrollit të infeksioneve spitalore dhe të tjera. Flet gjuhën angleze. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Në zgjedhjet lokale në vitin 2025, për herë të dytë radhazi, popullata ia ka besuar besimin për ta kryer funksionin e kryetarit të Komunës së Manastirit.

Општина БОГОВИЊЕ

Градоначалник: ФЕТИ АБАЗИ

Фети Абази е роден на 25 април 1976 година. Основно образование завршил во Боговиње, а средно училиште во „Кирил Пејчиновиќ“ во Тетово. Студирал на Факултетот за архитектура, на Политехничкиот универзитет во Тирана. Започнал да работи во 2001 година, во приватниот сектор, како дизајнер. Од 2006 година работи во администрацијата на Општина Боговиње, прво како соработник во Секторот за урбанизам, во 2010 година бил консултант и овластен инспектор за градба; во 2017 година станал раководител на Секторот за урбанизам и во 2021 година овластен инспектор за градба во општината. Од 2024 година повторно се вратил во приватниот сектор. Учествовал на бројни семинари, конференции и обуки за локална самоуправа и за современи стандарди на урбанистичко планирање. Во текот на својата кариера реализирал бројни проекти: индивидуални станбени, индустриски, комерцијални и инфраструктурни. Оженет е и татко на две деца.



Komuna e BOGOVINËS

Kryetar: FETI ABAZI

Feti Abazi është lindur më 25 prill 1976. Arsimin fillor e ka mbaruar në Bogovinë, ndërsa shkollën e mesme në “Kiril Pejčinoviç”, në Tetovë. Ka studiuar në Fakultetin e Arkitekturës, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ka filluar të punojë në vitin 2001, në sektorin privat, si dizajner. Që nga viti 2006 punon në administratën e Komunës së Bogovinës, fillimisht si bashkëpunëtor në sektorin e urbanizmit, në vitin 2010 ka qenë konsulent dhe inspektor i autorizuar për ndërtim; në vitin 2017 është bërë drejtues i Sektorit të urbanizmit dhe në vitin 2021 inspektor i autorizuar për ndërtim në komunë. Në vitin 2024 është rikthyer përsëri në sektorin privat. Ka marrë pjesë në seminare, konferenca dhe trajnime të shumta për vetëqeverisjen lokale dhe për standardet bashkëkohore të planifikimit urbanistik. Gjatë karrierës së tij ka realizuar projekte të shumta: individuale banesore, industriale, komerciale dhe infrastrukture. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина БОСИЛОВО

Градоначалник: РИСТО МАНЧЕВ

Ристо Манчев е роден на 14 јуни 1981 година во Струмица. Основно образование завршил во Моноспитово, а средно во Струмица (природно-математичка гимназија). Дипломирал на Економскиот факултет во Прилеп, насока Сметководство, финансии и ревизија. Во 2010 година добил стипендија од Министерството за надворешни работи на Италија, по што во 2011 година се стекнал со мастер диплома за високи европски студии на Фондацијата на Европскиот колеџ во Парма (Fondazione Collegio Europeo di Parma), а во 2013 година се стекнал со титулата – магистер по високи европски студии на Правниот факултет во Парма (Facolta di Giurisprudenza di Parma- Italia). Од 2005 до 2013 година бил сопственик и управител на претпријатието за градежништво и трговија со градежни материјали „Н&Р Конструкција РТАН“ - Моноспитово. Од 2011 до 2015 година бил член на Републичкиот совет за безбедност на сообраќајот на патиштата (РСБСП), од 2015 година до 2019 година ја извршувал функцијата секретар на РСБСП, а потоа работел во администрацијата на Советот. Во 2014 година од Агенцијата за поддршка на претприемништво на РМ бил ангажиран како овластен консултант за изработка на бизнис-планови и обезбедување на консултантски услуги за бизнис- планирање, маркетинг, истражување на пазарот, финансиско планирање и друго. Работел и на проекти финансиски поддржани од ИПА-програмата за прекугранична соработка. Активно ги користи англискиот и италијански јазик и поседува вештини за работа со компјутери и компјутерски програми. Оженет е и татко на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, е избран за градоначалник на Општина Босилово.



Komuna e BOSILLOVËS

Kryetar: RISTO MANÇEV

Risto Manchev është lindur më 14 qershor 1981, në Strumicë. Arsimimin fillor e ka mbaruar në Monospitovë, ndërsa atë të mesëm në Strumicë (gjimnazi natyror-matematik). Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Prilep, në drejtimin e kontabilitetit, financave dhe auditimit. Në vitin 2010 ka marrë bursë nga Ministria e Punëve të

Jashtme të Italisë, pas së cilës në vitin 2011 ka fituar diplomën e masterit për studime të larta evropiane në Fondacionin e Kolehxit Evropian në Parmë (Fondazione Collegio Europeo di Parma), ndërsa në vitin 2013 ka marrë titullin – magjistër për studime të larta evropiane në Fakultetin Juridik në Parmë (Facolta di Giurisprudenza di Parma – Italia). Nga viti 2005 deri në vitin 2013 ka qenë pronar dhe menaxher i ndërmarrjes për ndërtim dhe tregti me materiale ndërtimore “N&R Konstruksija RTAN” - Monospitovë. Nga viti 2011 deri në vitin 2015 ka qenë anëtar i Këshillit Republikan për Sigurinë e Trafikut në Rugë (KRSTR), nga viti 2015 deri në vitin 2019 ka ushtruar detyrën e sekretarit të KRSTR-it, dhe më pas ka punuar në administratën e Këshillit. Në vitin 2014 nga Agjencia për Mbështetje të Sipërmarrjes së RM-së u angazhua si konsulent i autorizuar për përgatitjen e planeve të biznesit dhe sigurimin e shërbimeve konsultative për planifikimin e biznesit, marketingun, hulumtimin e tregut, planifikimin financiar dhe të tjera. Ka punuar gjithashtu në projekte të mbështetur financiarisht nga programi IPA për bashkëpunim ndërkufitar. Përdor gjuhën angleze në mënyrë aktive dhe italiane dhe ka shkathtësi për të punuar me kompjuterë dhe programe kompjuterike. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, u zgjodh si kryetar i Komunës së Bosillovës.

Општина БРВЕНИЦА

Градоначалник: ЈОВИЦА ИЛИЕВСКИ

Јовица Илиевски е роден на 3 мај 1968 година во Тетово. Основно образование завршил во родното место Чelopeк, а средно образование во Училиштен медицински центар „Никола Штејн“ во Тетово. Од 1999 до именувањето за градоначалник на Општина Брвеница во 2021 година, работел во ЈЗУ Клиничка болница Тетово. Во периодот од 2013 до 2017 година бил член на Советот на Општина Брвеница. Го сака спортот, особено фудбалот, и бил организатор на голем број спортски настани. Од 2001 до 2013 година учествувал во млади категории, во рамките на Фудбалската федерација на Македонија. Од 2013 до 2021 година е член во U21 млада репрезентација во рамките на ФФМ, а од средината на 2021 година член е и на А репрезентацијата во ФФМ. Од 2016 година е потпретседател на Фудбалскиот сојуз Тетово. Активно го користи англискиот јазик. Оженет е и татко на две деца.



Komuna e BËRVENICËS

Kryetar: JOVICA ILIEVSKI

Jovica Ilievski është lindur më 3 maj 1968 në Tetovë. Arsimin fillor e ka mbaruar në vendlindjen e tij Çelopek, ndërsa arsimin e mesëm në Qendrën Mjekësore Shkollore “Nikolla Shtejn”, në Tetovë. Nga viti 1999 deri në emërimin e tij si kryetar i Komunës së Bërvenicës në vitin 2021, ka punuar në IPSH Spitalin Klinik Tetovë. Në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Bërvenicës. E do sportin, veçanërisht futbollin dhe ka qenë organizator i një numri të madh ngjarjesh sportive. Nga viti 2001 deri në vitin 2013 ka marrë pjesë në kategoritë e të rinjve në kuadër të Federatës së Futbollit të Maqedonisë. Nga viti 2013 deri në vitin 2021 është anëtar i përfaqësueses U21 në kuadër të FFM-së, ndërsa nga mesi i vitit 2021 është anëtar i përfaqësueses A në FFM. Që nga viti 2016 është nënkryetar i Lidhjes së Futbollit Tetovë. Përdor gjuhën angleze në mënyrë aktive. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина БУТЕЛ

Градоначалник: ДАРКО КОСТОВСКИ

Дарко Костовски е роден на 27 октомври 1988 година во Скопје. Во 2011 година дипломирал на политички студии на Правниот факултет при УКИМ, во Скопје, каде што е магистранд на насоката Применета политика и политички систем. Работната кариера ја започнал во 2014 година, во Министерството за труд и социјална политика, како советник во Кабинетот на министерот, каде што бил до 2017 година. Костовски е селектор и тренер на македонската теквондо репрезентација, носител на црн појас трет дан во олимписко теквондо и црн појас прв дан во џудо. Две години бил дел од македонската џудо репрезентација и двапати државен сениорски шампион во џудо. Тој е основач и тренер на теквондо клубот „Бутел“. Како тренер, достигнал врвни спортски резултати со македонската теквондо репрезентација, а најголем успех на репрезентацијата било освојувањето на сребрениот медал на Олимписките игри во Токио, во 2021 година. Со одлука на Архиепископот Охридски и Македонски г.г. Стефан, градоначалникот е одликуван со орден за посебен придонес за изградба и украсување на храмот „Свети 40 Севастиски маченици“. Покрај тоа, тој е награден од Црвениот крст на РМ за посебен придонес и плодна соработка. Активно го користи англискиот јазик. Оженет е и татко на три деца. На локалните избори во 2013 година бил избран за член на Советот на Општина Бутел. На парламентарните избори во 2020 година станал пратеник во Собранието на РСМ, до октомври 2021 година, кога се кандидирал на локалните избори за градоначалник и ја добил довербата од мнозинството жители на Општина Бутел. Поддршка од жителите по вторпат добил и на локалните избори во 2025 година.



Komuna e BUTELIT

Kryetar: DARKO KOSTOVSKI

Darko Kostovski është lindur më 27 tetor 1988 në Shkup. Në vitin 2011 ka diplomuar në studimet politike në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup, ku është magjistrant në degën e politikës aplikuese dhe sistemit politik. Karrierën e tij të punës e ka filluar në vitin 2014, në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, si këshilltar në Kabinetin e ministrit, ku ka qenë deri në vitin 2017. Kostovski është seleksionues dhe trajner i përfaqësueses së Maqedonisë të taekwondo-së, mbajtës i brezit të zi të gradës mjeshtërore të tretë në taekwondo olimpike dhe brezit të zi të gradës mjeshtërore të parë në xhudo. Për dy vjet ka qenë pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë të xhudos dhe dy herë kampion shtetëror senior në xhudo. Ai është themelues dhe trajner i klubit të taekwondo-së “Butel”. Si trajner, ka arritur rezultate të shkëlqyera sportive me përfaqësuesen e Maqedonisë të taekwondo-së, ndërsa suksesi më i madh i përfaqësueses ka qenë fitimi i medaljes së argjendtë në Lojërat Olimpike në Tokio në vitin 2021. Me vendim të Kryepiskopit të Ohrit dhe Maqedonisë, z.z. Stefan, kryetari i komunës është nderuar me urdhër për kontribut të veçantë në ndërtimin dhe zbulimin e tempullit “40 Martirët e Shenjtë të Sebastesë”. Përveç kësaj, ai është shpërblyer nga Kryqi i Kuq i RM-së për kontribut të veçantë dhe bashkëpunim frutdhënës. Përdor gjuhën angleze në mënyrë aktive. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës së Butelit. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 është bërë deputet në Kuvendin e RMV-së, deri në tetor 2021, kur është kandiduar në zgjedhjet lokale për kryetar komune dhe ka fituar besimin e shumicës së banorëve të Komunës së Butelit. Mbështetje nga banorët mori për herë të dytë edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2025.

Општина ВАЛАНДОВО

Градоначалник: ЃОКО КАМЧЕВ

Ѓоко Камчев е роден на 4 октомври 1975 година во Валандово. Основно образование завршил во родното место, а средно на Природно-математичката школа во Гевгелија. Во 1994 година дипломирал на Правниот факултет при УКИМ, во Скопје, насока Политички науки. Го сака спортот, зборува добро англиски јазик. Не е оженет. Во периодот 2005 – 2009 година бил член на Советот на Општина Валандово, а во следниот мандат 2009 – 2013 година бил и претседател на ова тело. Вршител на должност, директор на ЈП Комунален сервис „Комуналец“ Валандово бил во периодот 2007 – 2010 година. Од 2014 до 2016 и од 2019 до 2020 година бил пратеник во Собранието на РСМ. Од 2022 до 2025 година бил директор на Центарот за развој на Југоисточниот Плански Регион.



Komuna e VALLANDOVËS

Kryetar: GJOKO KAMÇEV

Gjoko Kamchev është lindur më 4 tetor 1975 në Vallandovë. Arsimin fillor e ka mbaruar në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në shkollën natyrore-matematikore në Gjevgjeli. Në vitin 1994 ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup, në drejtimin e shkencave politike. E do sportin, flet mirë gjuhën angleze dhe nuk është i martuar. Në periudhën e viteve 2005-2009 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Vallandovës, ndërsa në mandatin vijues 2009-2013 ka qenë edhe kryetar i këtij trupi. Ka qenë ushtrues detyre, drejtor i NP Shërbimi Komunal “Komunalec” Vallandovë në periudhën e viteve 2007-2010. Nga viti 2014 deri në vitin 2016 dhe nga viti 2019 deri në vitin 2020 ka qenë deputet në Kuvendin e RMV-së. Nga viti 2022 deri në vitin 2025 ka qenë drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Rajonit Planifikues Juglindor.

Општина ВАСИЛЕВО

Градоначалник: СЛАВЕ АНДОНОВ

Славе Андонов е роден на 5 септември 1986 година во Струмица. Основно образование завршил во родното Василево, средно во Струмица, а со високо образование се стекнал на Правниот факултет при УКИМ, во Скопје. Својата професионална кариера ја започнал во Општина Василево, во 2009 година, каде што работел на повеќе одговорни позиции и добил значително искуство за локалната самоуправа, административното право и јавната администрација. Зборува англиски јазик, активно ги следи програмите за локален и регионален развој и е поддржувач на иновативните пристапи во управувањето со јавните ресурси. Оженет е и татко на две деца. Во слободното време ужива во активностите во природа и поминување време со семејството. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Василево.



Komuna e VASILEVËS

Kryetar: SLLAVE ANDONOV

Sllave Andonov është lindur më 5 shtator 1986 në Strumicë. Arsimin fillor e ka mbaruar në vendlindjen e tij Vasilevë, atë të mesëm në Strumicë, ndërsa arsimimin e lartë e ka mbaruar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup. Karrierën e tij profesionale e ka nisur në Komunën e Vasilevës, në vitin 2009, ku ka punuar në disa pozita përgjegjëse dhe ka fituar përvojë të konsiderueshme në vetëqeverisjen lokale, të drejtën administrative dhe administratën publike. Flet gjuhën angleze, ndjek në mënyrë aktive programe për zhvillimin lokal dhe rajonal dhe është mbështetës i qasjeve inovative në menaxhimin e resurseve publike. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në kohën e lirë, ai gëzohet me aktivitete në natyrë dhe kalon kohë me familjen. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur si kryetar i Komunës së Vasilevës.

Општина ВЕВЧАНИ

Градоначалник: СПАСЕ КОЧОВСКИ

Спасе Кочовски е роден на 2 септември 1973 година во Струга. Основно образование завршил во Вевчани, средно стручно образование (математика и информатика) во гимназијата во Охрид. Дипломирал на Филозофскиот факултет при УКИМ, во Скопје, каде што се стекнал со звање, дипломиран социолог. Во 2009 година бил наставник по Социологија во СОУ „Нико Нестор“, а следната година во СОУ Гимназија „Д-р Ибрахим Темо“ во Струга. Учествувал во повеќе проекти од областа на социологијата, меѓу кои: проектот „Функционирањето на локалната самоуправа од 1996 до 2000 година“ во изработка на Институтот за социологија во Скопје и во подготовка на студијата „Супкултурата на младите во Скопје“ во изработка на Институтот за социолошки и правно-политички истражувања во Скопје. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Вевчани.



Komuna e VEVÇANIT

Kryetar: SPASE KOÇOVSKI

Spase Kočovski është lindur më 2 shtator 1973 në Strugë. Arsimin fillor e ka mbaruar në Vevçan, arsimin e mesëm profesional (matematikë dhe informatikë) në gjimnazin në Ohër. Ka diplomuar në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup, ku ka fituar titullin sociolog i diplomuar. Në vitin 2009 ka qenë mësues i sociologjisë në SHMK “Niko Nestor”, ndërsa vitin vijues në SHMK Gjimnazi “Dr. Ibrahim Temo” në Strugë. Ka marrë pjesë në disa projekte në fushën e sociologjisë, ndër të cilat: projekti “Funksionimi i vetëqeverisjes lokale nga viti 1996 deri në vitin 2000”, i përpiluar nga Instituti i Sociologjisë në Shkup dhe në përgatitjen e studimit “Subkultura e të rinjve në Shkup”, i përpiluar nga Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Juridiko-Politike në Shkup. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur si kryetar i Komunës së Vevçanit.

Општина ВЕЛЕС

Градоначалник: **МАРКО КОЛЕВ**

Марко Колев е роден на 13 април 1984 година во Велес. Високо образование завршил на Природно-математичкиот факултет, насока Географија, при УКИМ, Скопје. Од октомври 2009 година бил вработен во Центарот за развој на Вардарскиот Плански Регион, каде што од средината на 2013 година бил назначен за раководител. Во својот мандат реализирал и имплементирал над 100 проекти во општините од овој регион, од кои значаен број се инфраструктурни проекти со регионално значење. Во своето работење одржувал блиска соработка со бизнис-заедницата и невладиниот сектор и за успешноста во работењето, тој и институциите со кои раководел добиле голем број награди и признанија од домашни и меѓународни институции. Колев е татко на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, е избран за градоначалник на Општина Велес.



Komuna e VELESIT

Kryetar: **MARKO KOLEV**

Marko Kolev është lindur më 13 prill 1984 në Veles. Arsim të lartë ka mbaruar në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Matematikës, drejtimin gjeografi pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup. Që nga tetori i vitit 2009 ka qenë i punësuar në Qendrën për Zhvillimin e Rajonit Planifikues të Vardarit, ku nga mesi i vitit 2013 është emëruar si drejtor. Gjatë mandatit të tij ka realizuar dhe zbatuar mbi 100 projekte në komunat e këtij rajoni, nga të cilat një numër i konsiderueshëm janë projektet infrastrukturore me rëndësi rajonale. Në punën e tij ka mbajtur bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe sektorin e shoqërisë civile dhe për suksesin në punë, ai dhe institucionet që ka drejtuar kanë marrë një numër të madh çmimesh dhe njohesh nga institucione vendase dhe ndërkombëtare. Kolev është baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur kryetar i Komunës së Velesit.

Општина ВИНИЦА

Градоначалник:
МИТКО КОСТАДИНОВСКИ

Митко Костадиновски е роден на 9 мај 1978 година во Штип. Основно и средно образование завршил во Винаца, а високо образование на Меѓународниот славјански универзитет „Гаврило Романовиќ“ во Свети Николе, каде што се стекнал со звањето дипломиран економист – менаџер. Работната кариера ја започнал во 2003 година во ЈП „Солидарност“ – Винаца, каде што бил ангажиран до 2008 година. Во периодот од 2008 до 2024 година бил професионално посветен на работата во Шумската полиција при ЈП „Македонски шуми“. Во 2024 година бил назначен за началник на Шумската полиција на РСМ сè до изборот за градоначалник на Општина Винаца, на локалните избори. Во периодот од 2009 до 2017 година бил член на Советот на Општина Винаца.



Komuna e VINICËS

Kryetar:
MITKO KOSTADINOVSKI

Mitko Kostadinovski është lindur më 9 maj 1978 në Shtip. Arsimin fillor dhe atë të mesëm e ka mbaruar në Vinicë, ndërsa arsimin e lartë në Universitetin Ndërkombëtar Sllavjan “Gavrilo Romanoviç” në Sveti Nikole, ku ka fituar titullin ekonomist i diplomuar – menaxher. Karrierën e tij profesionale e ka nisur në vitin 2003 në NP “Solidarnost” – Vinicë, ku ka qenë i angazhuar deri në vitin 2008. Në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2024 ka qenë profesionalisht i angazhuar në punën e Policisë së Pyjeve pranë NP “Pyjet e Maqedonisë”. Në vitin 2024 është emëruar si shef i Policisë së Pyjeve të RMV-së deri në zgjedhjen për kryetar të komunës së Vinicës, në zgjedhjet lokale. Në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Vinicës.

Општина ВРАПЧИШТЕ

**ПОВЕРЕНИК од ВЛАДА на РСМ:
БУЊАМИН КАДРИУ**

Буњамин Кадриу е роден на 5 декември, 1985 година. Живее во село Добридол. Средно образование завршил во Гимназија "Панче Попоски" – Гостивар, а високо на Филолошки факултет/ албанологија . Освен албански и македонски јазик, одлично говори и англиски јазик, а поседува и добри вештини во информатичката технологија Кадриу работи како наставник по албански јазик. Со Одлука на Владата на РСМ од 25 ноември 2025 година, назначен е за повереник за вршење на работите од надлежност на градоначалник на Општина Врапчиште, до изборот на градоначалник на локалните избори што ќе се одржат на 11 јануари 2026 година.



Komuna e VRAPÇISHTIT

**I BESUAR nga QEVERIA e RMV-së:
BUNJAMIN KADRIU**

Bunjamin Kadriu është lindur më 5 dhjetor 1985. Jeton në fshatin Dobërdol. Arsimimin e mesëm e ka mbaruar në gjimnazin "Pançe Poposki" – Gostivar, ndërsa arsimin e lartë në Fakultetin Filologjik – albanologji. Përveç gjuhës shqipe dhe maqedonase, flet në mënyrë të shkëlqyeshme edhe gjuhën angleze, ndërsa ka aftësi të mira për teknologjinë informative. Kadriu punon si mësues i gjuhës shqipe. Me Vendim të Qeverisë së RMV-së më 25 nëntor 2025, është emëruar si nëpunës administrativ për kryerjen e detyrave nga kompetenca e kryetarit të Komunës së Vrapçishtit, deri në zgjedhjen e kryetarit të komunës në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 11 janar 2026.

Општина ГАЗИ БАБА

Градоначалник: БОБАН СТЕФКОВСКИ

Бобан Стефковски е роден на 14 јуни 1984 година во Скопје. Дипломирал на Филозофскиот факултет при УКИМ, Скопје, на Институтот за одбранбени и мировни студии, одбранбена насока, каде што се стекнал со звањето дипломиран професор по одбрана и заштита. Во периодот од 2010 до 2013 бил на магистерски студии на УКИМ, Институт за безбедност одбрана и мир, безбедносна насока и станал магистер по безбедносни науки. Во периодот од 2008 до 2013 бил соработник во Кабинетот на државниот секретар, Министерство за одбрана. Потоа од 2013 до 2015 бил во Министерството за труд и социјална политика во Секторот за поддршка на министерот. Следните две години бил државен советник во Министерството, во Секторот за заштита на децата, а до 2021 година бил државен советник во Секторот за водење на прекршочна постапка од областа на работни односи и безбедност и здравје при работа. Оженет е и татко на две деца. Во периодот од 2009 до 2013 бил член на Советот на Општина Гази Баба, а на локалните избори во 2025 година, граѓаните последователно, по вторпат му ја дале поддршката за извршување на функцијата градоначалник на Општина Гази Баба.



Komuna e GAZI BABËS

Kryetar: BOBAN STEFKOVSKI

Boban Stefkovski është lindur më 14 qershor 1984 në Shkup. Ai ka diplomuar në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi", Shkup, në Institutin për Studime Mbrojtëse dhe Paqe, në drejtimin mbrojtës, ku ka fituar titullin profesor i diplomuar për mbrojtje dhe siguri. Në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2013 ka ndjekur studimet master në "Universitetin Shën Kirili dhe Metodi", Institutin për Siguri, Mbrojtje dhe Paqe, në drejtimin e sigurisë dhe është bërë magjistër për shkencat e sigurisë. Në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013 ka qenë bashkëpunëtor në Kabinetin e Sekretarit Shtetëror, Ministria e Mbrojtjes. Më pas nga viti 2013 deri në vitin 2015 ka punuar në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në Sektorin për Mbështetje të Ministrit. Dy vitet e ardhshme ka qenë këshilltar shtetëror në këtë Ministri, në Sektorin për mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa deri në vitin 2021 ka qenë këshilltar shtetëror në Sektorin për udhëheqjen e procedurave kundërvajtëse në fushën e marrëdhënieve të punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë. Ai është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës Gazi Babë, ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2025, qytetarët ia dhanë mbështetjen për herë të dytë radhazi për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës Gazi Babë.

Општина ГЕВГЕЛИЈА

Градоначалник: **АНДОН САРАМАНДОВ**

Андон Сарамандов е роден на 30 ноември 1981 година, во Гевгелија. Гимназија (природно-математичка насока) завршил во СОУ „Јосиф Јосифовски“ во родниот град. Дипломирал на Факултетот за земјоделски науки и храна при УКИМ, во Скопје. Работел три години во подрачната единица на МЗШВ, Гевгелија, а потоа пет години бил во Државниот инспекторат за земјоделство. Уште во раната младост покажал голема општествено-политичка ангажираност, особено со учество во креирањето на локалните политики за младите, а во периодот од 2004 до 2008 работел на промоција на младите артисти, залагајќи се за урбана Гевгелија. Бил член на КК „Кожув“, а една деценија бил и организатор на турнирот во кошарка „Гевдион“. Во периодот од 2017 до 2021 година бил член на Советот на Општина Гевгелија. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, ја добил довербата од граѓаните да ја извршува функцијата градоначалник на Општина Гевгелија.



Komuna e GJEVGJELISË

Kryetar: **ANDON SARAMANDOV**

Andon Saramandov është lindur më 30 nëntor 1981, në Gjevgjeli. Gjmnazin (në drejtimin natyror-matematikor) e ka mbaruar në SHMK „Josif Josifovski“ në qytetin e tij të lindjes. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“, në Shkup. Ka punuar për tre vjet në njësinë rajonale të MBPEU-së, Gjevgjeli, ndërsa më pas pesë vjet ka qenë në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë. Që në rininë e tij të hershme ka treguar angazhim të madh shoqëror-politik, veçanërisht me pjesëmarrjen e tij në krijimin e politikave lokale për të rinjtë, ndërsa në periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2008 ka punuar për promovimin e artistëve të rinj, duke u angazhuar për një Gjevgjeli urbane. Ka qenë anëtar i KB „Kozhuf“ dhe për një dekadë ka qenë edhe organizator i turneut të basketbollit „Gevdion“. Në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Gjevgjelisë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës së Gjevgjelisë.

Општина ГОСТИВАР

ПОВЕРЕНИК од ВЛАДА на РСМ:
ФАДИЛ ЦЕЛИЛИ

Фадил Целили е роден на 26.10.1969 година во Чеграње - Гостивар. Завршил Правен факултет на Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, и е магистер на правни науки, од областа на кривичното право. Од 2000 до 2004 година бил волонтер, приправник и стручен соработник во Основен суд Гостивар. Потоа работел во Влада на РСМ во Секретаријатот за спроведување на Рамковниот договор. Во периодот од 2005 до 2008 работел во Агенција за државни службеници. Бил судија /кривичар во Основен суд Гостивар во периодот од 2008 до 2014 година. Во периодот од 2010 до 2014 бил и на позиција заменик претседател на Основен суд Гостивар. Од 2014 година до изборот на повереник работел како адвокат. Женет и татко на две деца. Со Одлука на Владата на РСМ од 25 ноември, 2025 година, назначен е за повереник за вршење на работите од надлежност на градоначалник на Општина Гостивар, до изборот на градоначалник по локалните избори што ќе се одржат на 11 јануари 2026 година.



Komuna e GOSTIVARIT

I BESUAR nga QEVERIA e RMV-së:
FADIL XHELILI

Fadil Xhelili është lindur më 26 tetor 1969 në Çegran - Gostivar. Ka mbaruar Fakultetin Juriidik në Universitetin „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup dhe është magjistër për shkenca juridike, në fushën e së drejtës penale. Nga viti 2000 deri në vitin 2004 ka qenë vullnetar, praktikant dhe bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Themelore të Gostivarit. Më pas ka punuar në Qeverinë e RMV-së në Sekretariatin për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë. Në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2008 ka punuar në Agjencinë e nëpunësve shtetërorë. Ka qenë gjyqtar/penalist në Gjykatën Themelore të Gostivarit nga viti 2008 deri në vitin 2014. Në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2014 ka qenë edhe në pozitën e zëvendës kryetarit të Gjykatës Themelore të Gostivarit. Nga viti 2014 deri në zgjedhjen si i besuar ka punuar si avokat. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Me Vendim të Qeverisë së RMV-së nga 25 nëntori 2025, është emëruar si nëpunës administrativ për kryerjen e detyrave nga kompetenca e kryetarit të Komunës së Gostivarit, deri në zgjedhjen e kryetarit të komunës në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 11 janar 2026.

ГРАД СКОПЈЕ

Градоначалник: ОРЦЕ ЃОРЃИЕВСКИ

Орце Ѓорѓиевски е роден на 5 август 1987 година во Скопје. Дипломирал на Правниот факултет при УКИМ, во Скопје, на одделот Политички студии. Работното искуство го стекнал во приватниот сектор. Активно го користи англискиот јазик. Оженет е и татко на едно дете. Во периодот од 2017 до 2021 година бил член на Советот на Општина Кисела Вода. Во периодот од 2021 до 2025 година бил градоначалник на Општина Кисела Вода. Во јануари 2023 година бил избран за претседател на Управниот одбор на ЗЕЛС. На локалните избори во октомври 2025 година, се кандидирал за градоначалник на Град Скопје и ја добил довербата од граѓаните за извршување на оваа функција.



QYTETI I SHKUPIT

Kryetar: ORCE GJORGJIEVSKI

Orce Gjorgjievski është lindur më 5 gusht 1987, në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup, në degën Studime Politike. Përvojën e punës e ka fituar në sektorin privat. Përdor gjuhën angleze në mënyrë aktive. Është i martuar dhe baba i një fëmije. Në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës Kisella Vodë. Në periudhën e viteve 2021-2025 ka qenë kryetar i Komunës Kisella Vodë. Në janar 2023 është zgjedhur kryetar i Bordit Drejtues të BNJVL-së. Në zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2025, u kandidua për kryetar të Qytetit të Shkupit dhe fitoi besimin e qytetarëve për të ushtruar këtë funksion.

Општина ГРАДСКО

Градоначалник: КИРО НАЦКОВ

Киро Нацков е роден на 9 септември 1983 година во Градско. Средно образование завршил во СОУ „Св. Кирил и Методиј“ во Неготино. По завршувањето на студиите на Филозофскиот факултет во Скопје, работел како наставник по Историја во ООУ „Даме Груев“ во Градско, каде што во периодот од 2015 до 2017 бил директор на училиштето. Оженет е и татко на едно дете. Бил член на Советот на Општина Градско од 2013 до 2015 година. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Градско.



Komuna e GRADSKOS

Kryetar: KIRO NACKOV

Kiro Nackov është lindur më 9 shtator 1983, në Gradska. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në SHMK “Shën Kirili dhe Metodi” në Negotinë. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin Filozofik në Shkup, ka punuar si mësues historie në SHFK “Dame Gruev” në Gradska, ku në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka qenë drejtor i shkollës. Është i martuar dhe baba i një fëmije. Ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës Gradska nga viti 2013 deri në vitin 2015. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur kryetar i Komunës Gradska.

Општина ДЕБРЦА

Градоначалник: ЗЛАТКО СИЛЈАНОСКИ

Златко Силјаноски е роден на 24 август 1981 година во село Лешани. Завршил високо образование и е дипломиран економист. Во 2005 година ја основал компанијата „Дебрца Експрес“. Петнаесет години бил претседател на Здружението на превозници „Сонце и Галеби – Охрид и Дебрца“. Неколку години од животот минал во Австралија, но се вратил во родниот крај, каде што продолжил активно да учествува во локалната заедница, во црковните иницијативи и во поддршката на хуманитарни, спортски и културни активности во Општина Дебрца. Бил ктитор на изградбата на црквата „Св. Петка“ во село Лешани. Оженет е и татко на две деца.



Komuna e DEBËRCËS

Kryetar: ZLLATKO SILJANOSKI

Zlatko Sijanovski është lindur më 24 gusht 1981 në fshatin Leshani. Ka mbaruar arsim të lartë dhe është ekonomist i diplomuar. Në vitin 2005 ka themeluar kompaninë “Debrca Ekspres”. Për pesëmbëdhjetë vjet ka qenë kryetar i Shoqatës së Transportuesve “Dielli dhe Pëllumbat – Ohër dhe Debarcë”. Disa vite të jetës i ka kaluar në Australi, por është kthyer në vendlindje, ku ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në komunitetin lokal, në iniciativat kishtare dhe në mbështetje të aktiviteteve humanitare, sportive dhe kulturore në Komunën e Debarcës. Ka qenë kтитор i ndërtimit të kishës “Shën Petkë” në fshatin Leshani. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина ДЕБАР

Градоначалник: ФИСНИК МЕЛА

Фисник Мела е роден на 22 јуни 1984 година во Дебар. Дипломирал компјутерски науки на „Сити колеџ“, на Меѓународниот факултет на Универзитетот „Шефилд“ (Грција) во 2006 година. На истиот универзитет, во 2007 година магистрирал по софтверско инженерство и телекомуникации. Активно учествувал на водечки европски и светски ИТ-конференции и е член на Британското компјутерско друштво (British Computer Society - BCS). Кариерата ја започнал со ангажмани во компании во САД, Велика Британија, Израел и Македонија, меѓу кои е американската компанија „Тармак“ (Tarmac), каде што работел на проекти за познати платформи во образованието, „финтек“ секторот, логистиката и дигиталните услуги. Соработувал и со реномирани компании од Швајцарија, Германија и Словенија на развој на комплексни дигитални системи и модерни технолошки решенија. Професионалното искуство го надградувал и преку работата во „Слајс“ (Slice), Њујорк – водечка американска платформа за е-трговија на пица-индустријата, како и во „Бети Блокс“ (BettyBlocks), Холандија, глобален пионер во no-code технологиите. Во 2021 година ја основал „Ротера софтвер девелопмент“ (Rottera Software Development), компанија специјализирана за развој на веб и мобилни апликации, која успешно соработува со меѓународни партнери и стартапи. Како општествено одговорен граѓанин, волонтерски ја извршувал функцијата раководител на ИТ-одделот во Институтот за политички и меѓународни студии (ISPН). Од септември до декември 2024 година бил избран за советник на генералниот директор на Фондот за здравствено осигурување на РСМ (скратено работно време). Од декември 2024 до ноември 2025 бил заменик-генерален директор на Управата за јавни приходи, во Скопје.



Komuna e DIBRËS

Kryetar: FISNIK MELA

Fisnik Mela është lindur më 22 qershor 1984 në Dibër. Ka diplomuar në shkencat kompjuterike në “City College”, në Fakultetin Ndërkombëtar të Universitetit Sheffield (Greqi) në vitin 2006. Në të njëjtin universitet, në vitin 2007 është bërë magjistër për inxhinieri softuerike dhe telekomunikacione. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në TI konferenca të larta evropiane dhe botërore dhe është anëtar i British Computer Society (BCS). Karrierën e nisi me angazhime në kompani në SHBA, Britaninë e Madhe, Izrael dhe Maqedoni, ndër të cilat është kompania amerikane “Tarmac” (Tarmac), ku ka punuar në projekte për platforma të njohura në arsim, sektorin “fintek”, logjistikën dhe shërbimet digjitale. Ka bashkëpunuar edhe me kompani të njohura nga Zvicra, Gjermania dhe Sllovenia në zhvillimin e sistemeve digjitale komplekse dhe zgjidhjeve moderne teknologjike. Përvijën profesionale e ka përmirësuar edhe duke punuar në “Sllajs” (Slice), Njujork – platforma lidere amerikane për e-tregtinë në industrinë e picave, si dhe në “Beti Blloks” (BettyBlocks) Holandë, pionier global në teknologjitë no-code. Në vitin 2021 ka themeluar “Rotera Softver Development” (Rottera Software Development), një kompani e specializuar për zhvillimin e aplikacioneve web dhe mobile, e cila bashkëpunon me sukses me partnerë ndërkombëtarë dhe startup-e. Si një qytetar me përgjegjësi shoqërore, ka kryer në mënyrë vullnetare funksionin e drejtorit të departamentit të TI-së në Institutin për Studime Politike dhe Ndërkombëtare (ISPН). Nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2024 u zgjodh këshilltar i drejtorit të përgjithshëm të Fondit për Sigurimin Shëndetësor të RMV-së (kohë e shkurtuar pune). Nga dhjetori i vitit 2024 deri në nëntor të vitit 2025 ishte zëvendës drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së të Ardhurat Publike, në Shkup..

Општина ДЕМИР ХИСАР

Градоначалник: НИКОЛА НАЈДОВСКИ

Никола Најдовски е роден на 5 октомври 1983 година во Битола. По образование е магистер по хемија, на тема за хемиски материјали. Во периодот од 2009 до 2021 година работел како наставник по хемија во ООУ „Гоце Делчев“, Демир Хисар, каде што една година бил и директор на училиштето. Зборува англиски јазик. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, граѓаните му ја дале довербата да биде градоначалник на Општина Демир Хисар.



Komuna e DEMIR HISARIT

Kryetar: NIKOLLA NAJDOVSKI

Nikolla Najdovski është lindur më 5 tetor 1983 në Manastir. Me arsim është magjistër kimie, me temë për materialet kimike. Në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2021 ka punuar si mësues kimie në SHFK “Goce Dellçev”, Demir Hisar, ku për një vit ka qenë edhe drejtor i shkollës. Flet gjuhën angleze. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, qytetarët ia kanë dhanë besimin për të qenë kryetar i Komunës së Demir Hisarit

Општина ДЕМИР КАПИЈА

Градоначалник: НАТАЛИЈА ДИМИТРИЕВА

Наталија Димитриева е родена на 16 ноември 1977 година во Неготино. Таа е дипломиран професор по предучилишно образование и до изборот на градоначалник работела во ЈОУДГ „Борис Трајковски“ од Демир Капија, како професор на деца од предучилишна возраст. Во периодот од 2011 година до 2018 година ја вршела функцијата директор на оваа детската градинка, кога заради успешно работење, институцијата во 2014 година го добила признание „7 Ноември“ – Денот на Општина Демир Капија. Добро зборува англиски јазик, мажена е и мајка на две деца.



Komuna e DEMIR KAPISË

Kryetar: NATALIJA DIMITRIEVA

Natalija Dimitrieva është lindur më 16 nëntor 1977 në Negotinë. Ajo është profesoreshë e diplomuar në arsim parashkollor dhe deri në zgjedhjen e kryetares së komunës ka punuar në IKPKF „Boris Trajkovski“ nga Demir Kapi, si profesoreshë për fëmijët e moshës parashkollore. Në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2018 ka ushtruar detyrën e drejtoreshës së këtij kopshti të fëmijëve, kur për shkak të punës së saj së suksesshme, institucioni në vitin 2014 mori çmimin „7 Nëntori“ – Dita e Komunës së Demir Kapisë. Flet mirë anglisht, është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve.

Општина ДЕЛЧЕВО

Градоначалник: ИВАН ГОЦЕВСКИ

Иван Гоцевски е роден на 23 февруари 1988 година во Штип. Основно и средно образование завршил во Делчево и продолжил на Економскиот факултет во УНСС, Софија (Бугарија), при што се стекнал со звање дипломиран економист, специјалност и бизнис-администрација, а потоа станал магистер по бизнис и администрација. Најголемото работно искуство го стекнал во приватниот сектор, како комерцијалист во делчевската фирма „БРЕГАЛ ДОО“, а работел и во „РУДИНЕ ММ“, каде што бил одговорен за сезонската преработка на плодови од вишна и слива. Дobar познавач е на состојбите во земјоделството, со голем акцент на овоштарството, каде максимално се залагал за поддршка на земјоделците, особено за откуп и пласман на овошјето. Познат е и како голем хуманист и поддржувач на маргинализираните категории на граѓани. Гоцевски е оженет и татко на две деца. Го сака спортот и го поддржува делчевскиот Фудбалски клуб „Брегалиница“, каде членувал во сите младински категории на клубот. Во периодот од 2021 до 2025 година бил член на Советот на Општина Делчево.



Komuna e DELLÇEVËS

Kryetar: IVAN GOCEVSKI

Ivan Gocevski është lindur më 23 shkurt 1988 në Shtip. Arsimin fillor dhe atë të mesëm e ka mbaruar në Dellçevë dhe ka vazhduar në Fakultetin Ekonomik të UEKB-it, Sofje (Bullgari), ku ka fituar titullin ekonomist i diplomuar, me specializim në administratën e biznesit, dhe më pas është bërë magjistër për biznes dhe administratë. Përvojën më të madhe të punës e ka fituar në sektorin privat, si komercialist në firmën e Dellçevës „BREGAL DOO“, dhe ka punuar edhe në „RUDINE MM“, ku ka qenë përgjegjës për përpunimin sezonal të frutave të vishnjës dhe kumbullës. Ai është njohës i mirë i gjendjeve në bujqësi, me një theks të madh në sferën e frutarisë, ku ka bërë përpjekje maksimale për mbështetje të bujqve, veçanërisht për blerjen dhe shpërndarjen e frutave. Është i njohur edhe si një humanist i madh dhe mbështetës i kategorive të marginalizuara të qytetarëve. Gocevski është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Ai e do sportin dhe mbështet klubin e futbollit të Dellçevës „Bregallnica“, ku ka qenë anëtar në të gjitha kategoritë e të rinjve të klubit. Në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2025 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Dellçevës.

Општина ДОЈРАН

Градоначалник: ИЛИЈА ТЕНТОВ

Илија Тентов е роден на 1 јуни 1988 година. Гимназија завршил во СОУ „Богданци“ во Богданци, а дипломирал на Економскиот факултет при УКИМ, Скопје. Во периодот од 2011 до 2016 година имал сопствена фирма за туризам и угостителство. Потоа работел во комерција во градежната фирма ДГТ „Жикол“, а од 2019 година повторно работи во сопствена фирма за туризам и угостителство. Го сака спортот и шахот.



Komuna e DOJRANIT

Kryetar: ILIJA TENTOV

Ilija Tentov është lindur më 1 qershor 1988. Gjimnazin e ka mbaruar në SHMK „Bogdanci“ në Bogdanci, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“, Shkup. Në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016 ka pasur firmën e tij për turizëm dhe hotelieri. Më pas ka punuar në tregti në firmën ndërtimore DGT „Zhikoll“, ndërsa nga viti 2019 punon përsëri në firmën e tij për turizëm dhe hotelieri. E do sportin dhe shahun.

Општина ДОЛНЕНИ

Градоначалник: БЛЕРИМ ИСЛАМИ

Роден е на 21 февруари 1991 година во селото Црнилиште. Потекнува од економски просечно семејство со родител посветен на едукација на младите од овој крај. Основното образование го завршил во родното место, а средно училиште во ОСУ „Рилиндја – Преродба“ во Житоше, при што покажал високи резултати и одличен успех и бил еден од најистакнатите ученици во генерација. Високото образование го продолжил на Државниот тетовски универзитет, на Факултетот за природно-математички науки, насока Математика. По завршувањето на студиите се посветил на професијата во родното место, како наставник по предметот Математика. Женет е и татко на две деца.



Komuna e DOLLNENIT

Kryetar: BLERIM ISLAMI

Është lindur më 21 shkurt 1991 në fshatin Cërnilisht. Vjen nga një familje me të ardhura mesatare ekonomike, me prind që është i përkushtuar për edukimin e të rinjve nga ky rajon. Arsimin fillor e ka mbaruar në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në SHMK “Rilindja – Prerodba” në Zhitoshë, ku ka treguar rezultate të larta dhe sukses të shkëlqyer, duke qenë një nga nxënësit më të dalluar të gjeneratës. Arsimin e lartë e ka vazhduar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Matematikës, në drejtimin e Matematikës. Pas përfundimit të studimeve, iu përkushtua profesionit në vendlindje si mësues i lëndës matematikë. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина ЃОРЧЕ ПЕТРОВ

Градоначалник:
АЛЕКСАНДАР СТОЈКОСКИ

Александар Стојкоски е роден на 12 март 1982 година. Средно училиште завршил во гимназијата „Раде Јовчевски Корчагин“ во Скопје, а во декември 2007 година, дипломирал на Медицинскиот факултет при УКИМ, во Скопје. Следната година запишал специјализација по радиологија, а во периодот септември – ноември 2012 година се усовршувал во оваа област на Универзитетот во Мичиген (САД). Во 2020 година запишал докторски студии на Медицинскиот факултет во Скопје. Од 2013 година работел како специјалист радиолог во ЈЗУ Универзитетски институт за радиологија и бил асистент-докторанд на Медицинскиот факултет при УКИМ. Зборува добро англиски јазик. Оженет е и татко на две деца. Хоби му е планинарење и прошетки во природата. Во периодот 2009 – 2014 бил претседател на Советот на Општина Ѓорче Петров. Од мај 2014 година до декември 2016 ја извршувал функцијата пратеник во Собранието на РМ. На локалните избори во 2025 година последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Ѓорче Петров.



Komuna e GJORÇE PETROVIT

Kryetar:
ALEKSANDAR STOJKOSKI

Aleksandar Stojkoski është lindur më 12 mars 1982. Shkollën e mesme e ka mbaruar në gjimnazin “Rade Jovčevski Korçagin” në Shkup, dhe në dhjetor të vitit 2007, ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup. Vitin vijues është regjistruar për specializimin në radiologji, ndërsa në periudhën shtator – nëntor 2012 është përsosur në këtë fushë në Universitetin e Miçiganit (SHBA). Në vitin 2020 është regjistruar për studimet doktorale në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup. Që nga viti 2013 ka punuar si specialist radiolog në IPSH Instituti Universitar për Radiologji dhe ka qenë asistent doktorant në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”. Flet mirë gjuhën angleze. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Hobi i tij është ngjitja në mal dhe shëtitjet në natyrë. Në periudhën e viteve 2009 – 2014 ka qenë kryetar i Këshillit të Komunës së Gjorçe Petrovit. Nga maji i vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2016 ka ushtruar detyrën e deputetit në Kuvendin e RM-së. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025 është zgjedhur për herë të dytë radhazi si kryetar i Komunës së Gjorçe Petrovit.

Општина ЖЕЛИНО

Градоначалник: БЛЕРИМ СЕЈДИУ

Блерим Сејдиу е роден на 4 септември 1985 година во Тетово. Основно образование завршил во училиштето „Пашко Васа“ во Групчин, а средно образование во гимназијата „Кирил Пејчиновиќ“ во Тетово. Правен факултет завршил на Универзитетот на Југоисточна Европа, во Тетово, а постдипломските студии на Универзитетот ФОН во Скопје, каде што се стекнал со титулата магистер во областа на правните науки. Во својата професионална кариера работел како правник, а бил и секретар на Фудбалскиот клуб „Шкендија“ во 2008 – 2011 година. Од 2010 до 2016 година бил шеф на Правниот оддел на Меѓународниот балкански универзитет во Скопје. Оженет е и татко е на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по третпат, граѓаните му ја дале довербата да биде градоначалник на Општина Желино.



Komuna e ZHELINËS

Kryetar: BLERIM SEJDIU

Blerim Sejdiu është lindur më 4 shtator 1985 në Tetovë. Arsimin fillor e ka mbaruar në shkollën “Pashko Vasa” në fshatin Grupçin, ndërsa arsimin e mesëm në gjimnazin “Kirill Pejçinoviç” në Tetovë. Fakultetin Juridik e ka mbaruar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin FON në Shkup, ku ka fituar titullin magjistër në fushën e shkencave juridike. Në karrierën e tij profesionale ka punuar si jurist, ndërsa ka qenë edhe sekretar i Klubit të Futbollit “Shkëndija” nga viti 2008 deri në vitin 2011. Nga viti 2010 deri në vitin 2016 ka qenë shef i Departamentit juridik në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik në Shkup. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të tretë radhazi, qytetarët ia kanë dhanë besimin për të qenë kryetar i Komunës së Zhelinës.

Општина ЗЕЛЕНИКОВО

Градоначалник: КОСТА МАНЕВСКИ

Коста Маневски е роден на 31 јули 1986 година во Скопје. Основно образование завршил во родното Зелениково, а средно и високо образование завршил во Скопје и се стекнал со звање дипломиран економист. Професионалната кариера ја започнал на 18-годишна возраст. Во 2009 година се вработил во Службата за општи и заеднички работи при Владата на РМ. Во периодот од 2009 до 2019 година бил ангажиран како соработник во Кабинетот на Претседателот на Република Македонија, каде што добил и повеќе благодарници за особен придонес во подготовка и реализација на Меѓународната школа за млади лидери. Од 2019 година бил вработен во посебен орган на државната управа. Уште од рана возраст активно се вклучил во градење на политики за развој на својата општина. На негова иницијатива биле спроведени повеќе хуманитарни и донаторски акции, а голем придонес имал и во организирањето на многу спортски и културно-уметнички настани на локално ниво. Оженет е и татко на три деца. На последните локални избори, последователно, по вторпат, ја добил довербата од граѓаните за функцијата градоначалник на Општина Зелениково.



Komuna e ZELENIKOVËS

Kryetar: KOSTA MANEVSKI

Kosta Manevski është lindur më 31 korrik 1986 në Shkup. Arsimimin fillor e ka mbaruar në vendlindjen e tij Zelenikovë, ndërsa arsimin e mesëm dhe atë të lartë e ka mbaruar në Shkup dhe ka fituar titullin ekonomist i diplomuar. Karrierën profesionale e ka nisur në moshën 18-vjeçare. Në vitin 2009 është punësuar në Shërbimin për çështje të përgjithshme dhe të përbashkëta pranë Qeverisë së RM-së. Në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2019 ka qenë i angazhuar si bashkëpunëtor në Kabinetin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, ku ka marrë edhe shumë mirënjohje për kontributin e veçantë në përgatitjen dhe realizimin e Shkollës Ndërkombëtare për Liderë të Rinj. Që nga viti 2019 ka qenë i punësuar në një organ të veçantë të administratës shtetërore. Që në moshë të re është angazhuar në mënyrë aktive në ndërtimin e politikave për zhvillimin e komunës së tij. Me iniciativën e tij janë realizuar shumë aksione humanitare dhe donatorësh, ndërsa ka pasur një kontribut të madh edhe në organizimin e shumë ngjarjeve sportive dhe kulturore-artistike në nivel lokal. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në zgjedhjet e fundit lokale, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për funksionin e kryetarit të Komunës së Zelenikovës.

Општина ЗРНОВЦИ

Градоначалник: ВАНЧО МИТЕВ

Ванчо Митев е роден е на 11 август 1980 година во Кочани. Средното образование го завршил во ДУФК „Методи Митевски – Брицо“, Скопје, а дипломирал на Факултетот за физичка култура при УКИМ, во Скопје. Професионалната кариера ја започнал како наставник по Физичка култура во ОУ „Тодор Арсов“ – Зрновци, во 2005 година. Во периодот од 2014 до 2017 работел во приватниот сектор, во компанијата „Екооил“ од Кочани. Од 2018 до 2024 година ја извршувал функцијата директор на Пошта – Кочани.



Komuna e ZËRNOCIT

Kryetar: VANÇO MITEV

Vanço Mitev është lindur më 11 gusht 1980 në Koçan. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në SHSHKF “Metodi Mitevski – Brico”, Shkup, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin e Kulturës Fizike pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Karrierën profesionale e ka nisur si mësues i Kulturës Fizike në SHF “Todor Arsov” – Zërnoc, në vitin 2005. Në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2017 ka punuar në sektorin privat, në kompaninë “Ekooil” nga Koçani. Nga viti 2018 deri në vitin 2024 ka ushtruar detyrën e drejtorit të Postës – Koçan.

Општина ИЛИНДЕН

Градоначалник:
АЛЕКСАНДАР ГЕОРГИЕВСКИ

Александар Георгиевски е роден во јули 1984 година во Скопје. Дипломирал на Правниот факултет при УКИМ, во Скопје и се стекнал со звање дипломиран политиколог. Во 2013 година, образованието го продолжил на Факултетот за политички науки при Универзитетот ФОН во Скопје и магистрирал на насоката Европска и меѓународна политика и дипломатија. Професионалното искуство го градел во повеќе државни институции. Во периодот од 2008 до 2014 година работел во Министерството за надворешни работи, Министерството за правда и во Агенцијата за странски инвестиции и промоција на извозот, каде што ја извршувал функцијата помошник-раководител на Секторот за услуги на инвеститори. Од 2015 година преминал во Министерството за труд и социјална политика како раководител на Секторот за европски интеграции и меѓународна соработка, а потоа, од 2017 до октомври 2021 година, ја извршувал функцијата раководител на Секторот за стратешко планирање. На локалните избори во 2013 година бил избран за член на Советот на Општина Илинден, а во следниот мандат (2017 – 2021 година) ја извршувал функцијата претседател на Советот. На последните локални избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Илинден.



Komuna e ILINDENIT

Kryetar:
ALEKSANDAR GEORGIEVSKI

Aleksandar Georgievski është lindur në korrik 1984 në Shkup. Ai ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe ka fituar titullin politolog i diplomuar. Në vitin 2013 ka vazhduar arsimin e tij në Fakultetin e Shkencave Politike pranë Universitetit FON në Shkup dhe ka magjistruar në drejtimin e Politikës Evropiane dhe Ndërkombëtare dhe Diplomacisë. Përvijën profesionale e ka ndërtuar në disa institucione shtetërore. Në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2014 ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë për Investime të Huaja dhe Promovimin e Eksportit, ku ka kryer funksionin e ndihmës-udhëheqësit të Sektorit për shërbime të investitorëve. Në vitin 2015 ka kaluar në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale si drejtor i Sektorit për Integritet Evropiane dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, ndërsa më pas, nga viti 2017 deri në tetor të vitit 2021, ka kryer funksionin e udhëheqësit të Sektorit për Planifikim Strategjik. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës së Ilindenit, ndërsa në mandatin vijues (vitet 2017 – 2021) ka mbajtur funksionin e kryetarit të Këshillit. Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, ai është zgjedhur kryetar të Komunës së Ilindenit.

Општина ЈЕГУНОВЦЕ

Градоначалник:
ДИМИТАР КОСТАДИНОСКИ

Димитар Костадиноски е роден на 26 април 1977 година, во Тетово. Основно образование завршил во Шемшово, а средно училиште во ССОУ „Моша Пијаде“ во Тетово. На високото образование се стекнал со звање дипломиран професор по македонски јазик и литература, а завршил и специјалистички студии – дипломиран економист. Бил вработен како административен службеник во Општина Јегуновце од 2008 година до 2021. Оженет е и татко на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, граѓаните му ја довериле градоначалничката функција за Општина Јегуновце.



Komuna e JEGUNOVCIT

Kryetar:
DMITAR KOSTADINOSKI

Dimitar Kostadinovski është lindur më 26 prill 1977 në Tetovë. Arsimimin fillor e ka mbaruar në Shemshovë, ndërsa shkollën e mesme në SHMKP “Mosha Pijade” në Tetovë. Në arsimin e lartë ka fituar titullin profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë maqedonase, ndërsa ka mbaruar edhe studime specialistike – ekonomist i diplomuar. Ka punuar si punonjës administrativ në Komunën e Jegunocit nga viti 2008 deri në vitin 2021. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, qytetarët ia kanë besuar për herë të dytë radhazi funksionin e kryetarit të Komunës së Jegunocit.

Општина КАВАДАРЦИ

Градоначалник: МИТКО ЈАНЧЕВ

Митко Јанчев е роден на 1 ноември 1981 година. Дипломирал на Универзитетот „Гоце Делчев“ во Штип, каде што ги завршил и магистерските студии, на отсекот на техничките науки, петрологија, минералологија и геохемија. Во 2022 година докторирал на тема „Еколошка жешка точка – депонија за индустриски отпад „ХИВ Велес“, минералошки, геохемиски и радиохемиски истражувања“ и се стекнал со научното звање доктор на технички науки. Сопственик е на ДПТУ „Кожувчанка“ од Кавадарци, компанија за производство на вода, каде функцијата на управител ја презел на 23-годишна возраст, по ненадејната смрт на неговиот татко, кој бил нејзин основач. Особено е горд што ја имал привилегијата да биде назначен за претседател на Иницијативниот одбор за изградба на црквата „Света Петка“ во Кавадарци, каде што се јавува и како еден од поголемите инвеститори на светиот храм. Во 2018-тата година ја основал фондацијата „Никола Јанчев“, која го носи името на неговиот татко, со цел да им помага на луѓето преку хуманитарни активности и каде што секој месец ја префрла и својата градоначалничка плата. Заедно со Советот на Општината успеал да реализира низа проекти за подобрување на условите за живот и на услугите на граѓаните, а особено е горд на успешното реализирање на проектот „Мој општинар“ преку кој општината е во постојан непосреден контакт со граѓаните. На локалните избори во 2025 година, последователно, по третпат, жителите го избрале за градоначалник на Општина Кавадарци.



Komuna e KAVADARIT

Kryetar: MITKO JANÇEV

Mitko Janchev është lindur më 1 nëntor 1981. Ka diplomuar në Universitetin „Goce Dellçev“ në Shtip, ku ka mbaruar edhe studimet e magjistratit, në drejtimin e shkencave teknike, petrologjisë, mineralogjisë dhe gjeokimisë. Në vitin 2022 është bërë doktor shkencash me temën “Pika e nxehtë ekologjike – deponia për mbeturinat industriale “HIV Veles”, hulumtimet minerologjike, gjeokimike dhe radiokimike” ka fituar titullin shkencor doktor i shkencave teknike. Është pronar i SHPTSH “Kozhuvçanka” nga Kavadarci, kompania për prodhimin e ujit, ku funksionin e drejtuesit e ka marrë në moshën 23 vjeçare, pas vdekjes së papritur të babait të tij, i cili ka qenë themeluesi i saj. Është veçanërisht krenar që ka pasur privilegjin të emërohet për kryetar të Bordit iniciativ për ndërtimin e kishës “Shën Petka” në Kavadarci, ku paraqitet edhe si një nga investitorët më të mëdhenj të tempullit të shenjtë. Në vitin 2018 ka themeluar fondacionin “Nikolla Janchev”, që mban emrin e babait të tij të ndjerë, me qëllimin e vetëm për të ndihmuar njerëzit përmes aktiviteteve humanitare dhe ku për çdo muaj transferon pagën e tij të kryetarit të komunës. Së bashku me Këshillin e komunës ka arritur të realizojë një sërë projektsh për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të kushteve të qytetarëve dhe është veçanërisht krenar për realizimin e suksesshëm të projektit “Nëpunësi i komunës sime” përmes të cilit komuna është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të tretë radhazi, banorët e kanë zgjedhur atë për kryetar të Komunës së Kavadarit.

Општина КАРБИНЦИ

Градоначалник: ВИКТОР ПАУНОВ

Виктор Паунов е роден на 30 април 1990 година во Штип. Дипломирал на Факултетот за музичка уметност на Универзитетот „Гоце Делчев“ во Штип. На истиот факултет е магистранд на музичка теорија и педагогија. Досегашното работно искуство го стекнал во приватниот сектор, во областа на транспорт и логистика. Работел за германската компанија „Мајер-Мајер“ (Mayer&Mayer) за организација на меѓународен транспорт за Тунис и Мароко, но и за неколку европски земји. Во текот на работењето се стекнал со повеќе меѓународни сертификати. Зборува одлично англиски јазик. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, жителите му ја довериле градоначалничката функција за Општина Карбинци.



Komuna e KARBINCIT

Kryetar: VIKTOR PAUNOV

Viktor Paunov është lindur më 30 prill 1990 në Shtip. Ka diplomuar në Fakultetin e Artit Muzikor në Universitetin „Goce Dellçev“ në Shtip. Në të njëjtin fakultet është magjistrant i teorisë së muzikës dhe pedagogjisë. Përvojën e deritanishme të punës e ka marrë në sektorin privat, në fushën e transportit dhe logjistikës. Ka punuar në kompaninë gjermane „Majer-Majer“ (Meyer&Meyer) për organizimin e transportit ndërkombëtar për Tunizi dhe Maroko, por edhe në disa vende evropiane. Gjatë punës ka fituar një numër të madh certifikatash ndërkombëtare. E flet mirë gjuhën angleze. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, banorët ia kanë besuar funksionin e kryetarit të Komunës së Karbincit.

Општина КАРПОШ

Градоначалник: СОТИР ЛУКРОВСКИ

Сотир Лукровски е роден на 15 јули 1973 година во Скопје. Средно образование завршил во 1992 година во економското училиште „Моша Пијаде“ во Скопје, а во 2014 година дипломирал на Универзитетот „Гоце Делчев“ во Штип, на отсекот по економија. Поседува организациски способности што практично ги имплементирал како менаџер за продажба и маркетинг во фирмата „Медикус хелп“ во периодот од 2000 до 2010 година. Од 2010 до 2025 година бил помошник-директор за маркетинг и продажби, во компанијата „Алкалоид КОНС“ – Скопје. Во деловна конверзација одлично зборува англиски јазик.



Komuna e KARPOSHIT

Kryetar: SOTIR LLUKROVSKI

Sotir Llukrovski është lindur më 15 korrik 1973 në Shkup. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në vitin 1992 në shkollën ekonomike „Mosha Pijade“ në Shkup, ndërsa në vitin 2014 ka diplomuar në Universitetin „Goce Dellçev“ në Shkup, në degën e ekonomisë. Ai ka aftësi organizative që i ka zbatuar praktikisht si menaxher për shitje dhe marketing në kompaninë „Medikus Help“ në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010. Nga viti 2010 deri në vitin 2025 ka qenë ndihmës-drejtor për marketing dhe shitje në kompaninë „Alkaloid KONS“ – Shkup. Në konverzacoinin afarist flet gjuhën angleze në mënyrë të shkëlqyeshme.

Општина КОЧАНИ

Градоначалник: ВЛАДКО ГРОЗДАНОВ

Владко Грозданов дипломирал на Медицинскиот факултет, на Тракискиот универзитет во Стара Загора (Бугарија). Подоцна добил специјализација и завршил како прв специјалист по гинекологија и акушерство од Универзитетот „Гоце Делчев“ во Штип. Како лекар со над 20 години искуство во медицината, гинекологијата и акушерството, секогаш нудел професионален и хуман пристап. Усовршување од областа на гинекологијата и акушерството имал во Словенија, Бугарија и Германија. Член е на Лекарската комора на Македонија, Балканското лекарско друштво и на Здружението на гинеколози и акушери. Зборува англиски јазик. Фамилијарен човек е и татко на две деца.



Komuna e KOÇANIT

Kryetar: VLLADKO GROZDANOV

Vlladko Grozdanov ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin Trakian në Stara Zagora (Bullgari). Më vonë ka marrë specializimin dhe ka përfunduar si specialisti i parë në gjinekologji dhe obstetrikë nga Universiteti „Goce Dellçev“ në Shkup. Si mjek me mbi 20 vjet përvojë në mjekësi, gjinekologji dhe obstetrikë, gjithmonë ka ofruar një qasje profesionale dhe humane. Ka përmirësuar njohuritë e tij në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës në Slloveni, Bullgari dhe Gjermani. Është anëtar i Dhomës së Mjekëve të Maqedonisë, Shoqatës Mjekësore Ballkanike dhe të Shoqatës së Gjinekologëve dhe Obstetërve. Flet gjuhën angleze. Është një njeri familjar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина КИСЕЛА ВОДА

Градоначалник:

БЕТИ СТАМЕНКОСКА - ТРАЈКОСКА

Бети Стаменкоска-Трајкоска е родена на 19 април 1977 година во Скопје. Во 2001 година, на Институтот по географија при УКИМ, Скопје се стекнала со звање дипломиран професор по географија. Била професор во неколку основни и средни училишта во Скопје, каде што покрај наставата била посветена и на реализација на меѓународни проекти и спроведување на еколошки активности и проекти насочени кон локалната заедница. Се истакнувала во работата на билингвалните англиски и француски паралелки во гимназијата „Орце Николов“, каде што активно учествувала во меѓународни и франкофонски иницијативи и во развивањето на современи наставни активности. Автор е на учебници по географија, одобрени од МОН, како и автор, учесник и координатор во Еразмус+ проекти. Учествувала на повеќе професионални обуки во Франција и Англија, со акцент на модернизацијата на наставата и подигнување на образовните стандарди. Активно зборува англиски и француски јазик. Од 2020 до 2025 година била пратеник во Собранието на РСМ. На 22 јануари 2025 година, француската амбасада во нашата земја ја одликувала со високото признание „Витез од редот на академските палми“, за нејзиниот исклучителен придонес во промовирањето на француската култура, образованието и франкофонската заедница, како и за нејзината активна улога како пратеничка и претседателка на Франкофонската секција во парламентот.



Komuna e KISELLA VODËS

Kryetar:

BETI STAMENKOSKA – TRAJKOSKA

Beti Stamenkoska-Trajkoska është lindur më 19 prill 1977 në Shkup. Në vitin 2001, në Institutin e Gjeografisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup, ka fituar titullin profesoreshe e diplomuar e gjeografisë. Ka qenë profesoreshe në disa shkolla fillore dhe të mesme në Shkup, ku përveç mësimdhënies ka qenë e angazhuar në realizimin e projekteve ndërkombëtare dhe zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve ekologjike të orientuara ndaj komunitetit lokal. Është dalluar në punën e klasave bilinguale në anglisht dhe frëngjisht në gjimnazin “Orce Nikollov”, ku ka marrë pjesë në mënyrë aktive në iniciativa ndërkombëtare dhe frankofone dhe në zhvillimin e aktiviteteve moderne mësimore. Është autore e teksteve shkollore për gjeografi, të miratuara nga MASH-i, si dhe autore, pjesëmarrëse dhe koordinatore e projekteve Erasmus+. Ka marrë pjesë në shumë trajnime profesionale në Francë dhe Angli, me theks në modernizimin e mësimdhënies dhe ngritjen e standardeve arsimore. Flet gjuhën angleze dhe franceze në mënyrë aktive. Nga viti 2020 deri në vitin 2025 ka qenë deputete në Kuvendin e RMV-së. Më 22 janar 2025, Ambasada franceze në vendin tonë e nderoi me çmimin e lartë “Kalorës nga radhët e Palmave Akademike”, për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në promovimin e kulturës franceze, arsimit dhe komunitetit frankofon, si dhe për rolin e saj aktiv si deputete dhe presidente e Seksionit Frankofon në parlament.

Општина КИЧЕВО

Градоначалник:

АЛЕКСАНДАР ЈОВАНОВСКИ

Александар Јовановски е роден на 1 април 1976 година. Од најмлади години, покажувал интерес за општествените процеси и имал активен граѓански ангажман, а за доброто на заедницата значително придонел и со својата професија како лекар. Високото образование го стекнал на Медицинскиот факултет при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, каде што дипломирал на отсекот Општа медицина. По завршувањето на студиите, во 2006 година, се вработил како професор по медицински предмети во средното училиште ОСУ „Мирко Милески“ во Кичево. Во 2013 година, својата кариера ја продолжил во приватната здравствена установа „Драга Медика“. Голем љубител е на музиката и како млад, заедно со својот брат, основале музички бенд. Тој е фамилијарен човек и татко на три деца.



Komuna e KËRÇOVËS

Kryetar:

ALEKSANDAR JOVANSKI

Aleksandar Jovanovski është lindur më 1 prill 1976. Që nga mosha e re, ka shfaqur interes për proceset shoqërore dhe ka pasur angazhim aktiv qytetar, duke kontribuar ndjeshëm për mirëqenien e komunitetit edhe me profesionin e tij si mjek. Arsimin e lartë e ka mbaruar në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku ka diplomuar në degën Mjekësi e Përgjithshme. Pas përfundimit të studimeve, në vitin 2006, është punësuar si profesor i lëndëve mjekësore në shkollën e mesme SHMK “Mirko Mileski” në Kërçovë. Në vitin 2013, karrierën e tij e ka vazhduar në institucionin privat shëndetësor “Draga Medika”. Është një adhurues i madh i muzikës dhe si i ri, së bashku me vëllain e tij, kanë themeluar një grup muzikor. Ai është një njeri familjar dhe baba i tre fëmijëve.

Општина КОНЧЕ

Градоначалник: ЗЛАТКО РИСТОВ

Златко Ристов е роден на 1 март 1978 година во Радовиш. Живее во село Ракитец, Општина Конче. Средно образование завршил во ЗПУЦ „Димитар Влахов“ – Струмица, а високо, на Европскиот универзитет – Скопје, каде што дипломирал како детектив – криминалист. Професионалната кариера ја започнал во АРМ, како професионален војник – водник во единицата ЕЧН „Волци“ (2001 – 2008). Потоа преминал во МВР, каде што работел како полициски службеник во ЕБР (2008 – 2014), а подоцна и како помлад инспектор по ОНТДООМ (2014 – 2021) и помлад инспектор по општ криминалитет во ОВР Радовиш. Оженет е и татко на три деца, силно посветен на семејните и општествените вредности. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат бил избран за градоначалник на Општина Конче.



Komuna e KONÇES

Kryetar: ZLLATKO RISTOV

Zlatko Ristov është lindur më 1 mars 1978 në Radovich. Jeton në fshatin Rakitec, Komuna Konçe. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në QSHBU “Dimitar Vlahov” – Strumicë, ndërsa atë të lartë në Universitetin Evropian – Shkup, ku ka diplomuar si detektiv – kriminalist. Karrierën profesionale e ka nisur në ARM, si ushtar profesionist – nënoficer në njësinë NJQS “Ujqit” (2001–2008). Më pas ka kaluar në MPB, ku ka punuar si oficer policor në NJSHSH (2008–2014), ndërsa më vonë edhe si inspektor i ri në ONTDOOM (2014 – 2021) dhe inspektor i ri për krimin e përgjithshëm në SPB Radovich. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve, thellësisht i përkushtuar ndaj vlerave familjare dhe shoqërore. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur kryetar i Komunës Konçe.

Општина КРАТОВО

Градоначалник:
ТОДОРЧЕ НИКОЛОВСКИ

Тодорче Николовски е роден на 29 јуни 1981 година во Кратово. Дипломирал на Правниот факултет, правосудна насока, а потоа го положил и правосудниот испит. Во периодот од 2005 до 2008 година работел во Правната служба на Друштвото за вршење на административно-сметководствени и други деловни активности, заеднички служби во ДООЕЛ Кратово, при РИК СИЛЕКС АД. Кратово, а во периодот од 2008 до 2012 година бил управител на Друштвото за обезбедување на лица и имот СИЛФОР ДООЕЛ Кратово, основано од истата фирма. Од 2014 до 2018 година бил директор на Јавното претпријатие Хидросистем Злетовица“ Пробиштип. Во администрацијата на Општина Кратово работел како раководител на Одделението за правни, општи работи и јавни дејности во периодот од 2012 до 2014 и од 2018 до 2021 година. Добро зборува англиски јазик, оженет е и татко на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Кратово.



Komuna e KRATOVËS

Kryetar:
TODORÇE NIKOLLOVSKI

Todorçe Nikolovski është lindur më 29 qershor 1981 në Kratovë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik, në drejtimin e jurisprudencës, ndërsa më pas ka kaluar edhe provimin e jurisprudencës. Në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2008 ka punuar në Shërbimin Juridik të Shoqatës për kryerjen e aktiviteteve administrative-kontabile dhe aktiviteteve të tjera afariste, shërbime të përbashkëta në SH.PK.NJ.P. Kratovë, pranë RIK SILEKS SH.A. Kratovë, ndërsa në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2012 ka qenë drejtues i Shoqatës për sigurimin e personave dhe pronës SILFOR SH.PK.NJ.P. Kratovë, e themeluar nga e njëjta firmë. Nga viti 2014 deri në vitin 2018 ka qenë drejtor i Ndërmarrjes Publike Hidrosistemi Zletovicë në Probishtip. Në administratën e Komunës së Kratovës ka punuar si udhëheqës i Departamentit për çështje juridike, punë të përgjithshme dhe veprimtari publike në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2014 dhe nga viti 2018 deri në vitin 2021. Flet mirë anglisht, është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, u zgjodh kryetar i Komunës së Kratovës.

Општина КРИВА ПАЛАНКА

Градоначалник: САШКО МИТОВСКИ

Сашко Митовски е роден на 14 мај 1987 година во Крива Паланка. Високо образование завршил на Универзитетот за туризам и менаџмент во Скопје (УТМС), на Економскиот факултет, каде што дипломирал во 2018 година, во областа на економијата. Уште во средношколските денови организирал бројни концерти, забави, културни и спортски манифестации, турнири во мал фудбал, кои го привлекувале вниманието на младите, но и на пошироката јавност. Во периодот 2004 – 2006 година бил претседател на невладината организација „Регионален центар за развој“, преку која биле реализирани повеќе проекти што придонеле за подобрување на локалната заедница и поттикнување на младинскиот активизам. Веднаш по завршувањето на средното образование започнал приватен бизнис, отворил butik за машка облека и печатница за рекламен и промотивен материјал. Во 2010 година станал сопственик на Националниот ресторан „Воденица 3“, а во 2014 година го основал „Select Caffè“. Во периодот 2016 – 2018 година управувал и со „Пица бар Select“. Оженет е и татко на три деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по втор пат, ја добил довербата од граѓаните за градоначалник на Општина Крива Паланка.



Komuna e KRIVA PALLANKËS

Kryetar: SASHKO MITOVSKI

Sashko Mitovski është lindur më 14 maj 1987 në Kriva Pallankë. Arsimimin e lartë e ka mbaruar në Universitetin për Turizëm dhe Menaxhim në Shkup (UTMS), në Fakultetin Ekonomik, ku ka diplomuar në vitin 2018, në fushën e ekonomisë. Që në ditët e shkollës së mesme ka organizuar numër të madh koncertesh, argëtimesh, manifestimesh kulturore dhe sportive, turnesh në futboll të vogël, të cilat kanë tërhequr vëmendjen e të rinjve, por edhe të opinionit më të gjerë. Në periudhën e viteve 2004 – 2006 ka qenë president i organizatës joqeveritare “Qendra rajonale për zhvillim”, përmes së cilës janë realizuar disa projekte që kanë kontribuar në përmirësimin e komunitetit lokal dhe nxitjen e aktivizmit të të rinjave. Menjëherë pas përfundimit të arsimit të mesëm ka filluar një biznes privat, ka hapur një butik për veshje për burra dhe një shtypshkronjë për materiale reklamore dhe promovuese. Në vitin 2010 është bërë pronar i Restorantit Kombëtar “Vodenica 3”, ndërsa në vitin 2014 ka themeluar “Select Caffè”. Në periudhën e viteve 2016 – 2018 ka menaxhuar gjithashtu me “Pica bar Select”. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë, ka fituar besimin e qytetarëve për kryetar të Komunës Kriva Pallankë.

Општина КРИВОГАШТАНИ

Градоначалник: ИГОР КАРАВИЛОСКИ

Игор Каравилоски е роден на 21 мај 1980 година во Кривогаштани. Средно образование завршил во полициското училиште „Елисе Поповски Марко“ во Скопје – XXII класа. Високото образование го продолжил на УКЛО – Битола, при Економскиот факултет во Прилеп, каде што дипломирал на студиската програма Економија на претпријатија. Професионалната кариера ја започнал во 1999 година во Министерството за внатрешни работи, на повеќе раководни функции, меѓу кои: заменик-командир на полициска станица, инспектор за превенција, командир на полициско одделение, самостоен и главен инспектор за економски криминалитет и началник на Одделението за внатрешни работи. Во 2020 и 2024 година, за време на парламентарните избори е именуван за дополнителен заменик-началник на ОВР – Прилеп, согласно со изборните и законските процедури. Во текот на службената кариера учествувал на бројни специјализирани обуки и професионални усовршувања во земјата и странство, во области како: економски и компјутерски криминалитет, безбедносни стратегии, антитероризам, превенција во локалната заедница и менаџирање со човечки ресурси.



Komuna e KRIVOGASHTANIT

Kryetar: IGOR KARAVILLOSKI

Igor Karavilloski është lindur më 21 maj 1980 në Krivogashtan. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në shkollën policore “Elisie Popovski Mark” në Shkup – klasa XXII. Arsimin e lartë e ka vazhduar në Universitetin “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir, në Fakultetin Ekonomik në Prilep, ku ka diplomuar në programin e studimeve Ekonomia e Ndërmarrjeve. Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 1999 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në disa pozita udhëheqëse, ndër të cilat: zëvendës-komandant i stacionit policor, inspektor për parandalim, komandant i departamentit policor, inspektor i pavarur dhe kryesor për krimin ekonomik dhe shef i Departamentit të Punëve të Brendshme. Në vitet 2020 dhe 2024, gjatë zgjedhjeve parlamentare, është emëruar si zëvendës-shef i SPB-së – Prilep, në përputhje me procedurat zgjedhore dhe ligjore. Gjatë karrierës së tij shërbimi ka marrë pjesë në numër të madh trajnimesh të specializuara dhe përmirësimeve profesionale në vend dhe jashtë, në fusha si: krimi ekonomik dhe kompjuterik, strategjitë e sigurisë, antiterrorizmi, parandalimi në komunitetin lokal dhe menaxhimi i resurseve njerëzore.

Општина КРУШЕВО

Градоначалник: НИКО ЧОНЕСКИ

Нико Чонески е роден во 1979 година во Прилеп. Високо образование завршил на УКИМ, во Скопје, каде што дипломирал на Филозофскиот факултет, одсек Педагогија, а потоа и магистрирал во областа на воспитно-образовниот процес и управувањето во образованието. Од 2002 до 2009 година работел како наставник во ООУ „Никола Карев“ – Крушево, а во периодот 2009 – 2013 година бил директор на училиштето. Од 2017 година е сопственик и управител на фирмата „Тагас Балкан“, бренд со долга традиција во Крушево. Активно зборува англиски, француски и влашки јазик. Слободното време го посветува на риболов, сликарство и гастрономија. Оженет е и татко на две деца. Од 2013 до 2017 година бил претседател на Советот на Општина Крушево. Во својата јавна и деловна активност го промовира концептот „Еснафско Крушево“ – симбол на заедништво, поддршка и вреднување на локалната традиција и занаетчиство.



Komuna e KRUSHEVËS

Kryetar: NIKO ÇONESKI

Niko Çoneski është lindur në vitin 1979 në Prilep. Arsimin e lartë ka mbaruar në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku ka diplomuar në Fakultetin Filozofik, degën Pedagogji, ndërsa më pas ka magjistruar në fushën e procesit arsimor-edukativ dhe menaxhimit në arsim. Nga viti 2002 deri në vitin 2009 ka punuar si mësues në SHFK “Nikola Karev” – Krushevë, ndërsa në periudhën e viteve 2009 – 2013 ka qenë drejtor i shkollës. Që nga viti 2017 është pronar dhe drejtues i firmës “Tagas Ballkan”, një markë me traditë të gjatë në Krushevë. Flet gjuhën angleze, franceze dhe vllahe në mënyrë aktive. Kohën e lirë ia kushton peshkimit, pikturimit dhe gastronomisë. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka qenë kryetar i Këshillit të Komunës së Krushevës. Në aktivitetin e tij publik dhe afarist promovon konceptin “Krusheva e esnafit” – simbol i bashkësisë, mbështetjes dhe vlerësimit të traditës lokale dhe zejtarisë.

Општина КУМАНОВО

Градоначалник:
МАКСИМ ДИМИТРИЕВСКИ

Максим Димитриевски е роден на 29 ноември 1975 година во Куманово. Основно и средно образование завршил во родниот град, а дипломирал на Правниот факултет во Скопје. Во 2011 година го публикувал трудот на тема „Вкупни даночни приходи и расходи во ЕЛС со осврт на Општина Куманово“. Магистрирал во 2021 година на тема „Улогата на локалната самоуправа во вонредна и кризна состојба, во услови на епидемија со осврт на Општина Куманово“. Има долгогодишно работно искуство како приватен стопанственик. Тој е оженет и има три деца. Во 2008 година станал член на Советот на Општина Куманово, а во периодот 2012 – 2016 година и претседател на Советот. Политичката кариера ја продолжил како пратеник во Собранието на РСМ и бил претседател на Комисијата за одбрана и безбедност. На локалните избори во октомври 2025 година последователно, по третпат, бил избран за градоначалник на Општина Куманово.



Komuna e KUMANOVËS

Kryetar:
MAKSIM DIMITRIEVSKI

Maksim Dimitrievski është lindur më 29 nëntor 1975 në Kumanovë. Shkollën fillore dhe atë të mesme e ka mbaruar në qytetin e vendlindjes, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup. Në vitin 2011 ka publikuar punimin me temën “Të hyrat dhe të dalat totale tatimore në NJVL me theks në Komunën e Kumanovës”. Ka magjistruar në vitin 2021 me temën „Roli i vetëqeverisjes lokale në gjendje të jashtëzakonshme dhe krize, në kushte të një epidemie në lidhje me Komunën e Kumanovës”. Ka përvojë pune shumëvjeçare si biznesmen privat. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Në vitin 2008 është bërë anëtar i Këshillit të Komunës së Kumanovës, ndërsa në periudhën e viteve 2012-2016 edhe kryetar i këshillit. Karrierën politike e ka vazhduar si deputet në Kuvendin e RMV-së dhe ka qenë kryetar i Komisionit të mbrojtjes dhe sigurisë. Në zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2025, për herë të tretë radhazi, është zgjedhur për kryetar të Komunës së Kumanovës.

Општина ЛИПКОВО

Градоначалник: ЕРКАН АРИФИ

Еркан Арифи е роден на 19 октомври 1984 година во Куманово, а живее во село Матејче. Гимназија завршил во Липково, а Правен факултет на Универзитетот во Тетово. Магистрирал на правни науки (граѓанско право) на Универзитетот ФОН. Од 2004 година работел во државната администрација: во Министерството за транспорт и врски и во Општина Липково. Учествувал на голем број обуки и семинари и бил координатор за реализација на проекти за прекугранична соработка од ИПА фондовите. Оженет е и има две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по третпат, го добил мандатот за градоначалник на Општина Липково.



Komuna e LIKOVËS

Kryetar: ERKAN ARIFI

Erkan Arifi është lindur më 19 tetor 1984 në Kumanovë, ndërsa jeton në fshatin Mateç. Gjinnazin e ka mbaruar në Likovë, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Që nga viti 2004 ka punuar në administratën shtetërore në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe në Komunën e Likovës. Ka marrë pjesë në një numër të madh trajnimesh dhe seminaresh dhe ka qenë koordinator për realizimin e projekteve për bashkëpunim ndërkufitar nga fondet IPA. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herën e tretë radhazi, e ka marrë mandatin për kryetar të Komunës së Likovës.

Општина ЛОЗОВО

Градоначалник: БОШКО ЦВЕТКОВСКИ

Бошко Цветковски е роден на 2 мај 1985 година во Велес, а живее во Лозово. Средно образование завршил во СУГС „Владо Тасевски“ – ПТТ во Скопје, каде што се квалификувал во две стручни насоки и се стекнал со дипломи за ПТТ техничар и електротехничар за електроника и телекомуникации. Високото образование го стекнал на Универзитетот „Гоце Делчев“ – Штип, на студиската програма Применета политика и дипломатија, модул Европско право, каде што дипломирал како правник со 180 ЕКТС кредити. Академското образование го продолжил на Универзитетот „Гаврило Романович - Державин“ во Свети Николе, на кој се стекнал со звање дипломиран правник од областа на казненото право (240 ЕКТС). Професионалната кариера ја градел во Министерството за информатичко општество и администрација. Одлично ги познава англискиот и рускиот јазик, а има познавања и од шпанскиот и францускиот јазик. Располага со широк спектар на знаења од информатичката технологија и дигиталните компетенции. Во периодот 2013 - 2017 година бил член на Советот на Општина Лозово. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, ја добил довербата од граѓаните за функцијата градоначалник на Општина Лозово.



Komuna e LLOZOVËS

Kryetar: BOSHKO CVETKOVSKI

Boshko Cvetkovski është lindur më 2 maj 1985 në Veles, ndërsa jeton në Llozovë. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në SHMQSH “Vllado Tasevski” – PTT në Shkup, ku është kualifikuar në dy drejtime profesionale dhe ka fituar diploma si PTT teknik dhe elektroteknik për elektronikë dhe telekomunikacione. Arsimin e lartë e ka mbaruar në Universitetin “Goce Dellçev” – Shtip, në programin e studimeve Politika e Zbatuar dhe Diplomaci, moduli e Drejta Evropiane, ku ka diplomuar si jurist me 180 kreditë ECTS. Arsimin akademik e ka vazhduar në Universitetin “Gavrillo Romanoviç – Derzhavin” në Sveti Nikole, ku ka fituar titullin jurist i diplomuar në fushën e së drejtës penale (240 ECTS). Karrierën profesionale e ka ndërtuar në Ministrinë për Shoqërinë Informative dhe Administratën. E njeh shumë mirë gjuhën angleze dhe ruse, dhe ka njohuri edhe për gjuhën spanjolle dhe franceze. Disponon me një gamë të gjerë njohurish në teknologjinë informative dhe kompetencat digjitale. Në periudhën e viteve 2013 - 2017 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Llozovës. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për funksionin e kryetarit të Komunës së Llozovës.

Општина МАКЕДОНСКА КАМЕНИЦА**Градоначалник: СОЊА СТАМЕНКОВА**

Соња Стаменкова е родена на 11 февруари 1968 година во село Саса, во рударско семејство. Средното образование го завршила во гимназијата „Методија Митевски- Брицо“, насока Биологија и хемија, а потоа се школувала во средното медицинско училиште „Вељко Влаховиќ“ (денес „Јане Сандански“) во Штип, каде се стекнала со звањето медицинска сестра. Од 2009 до 2012 година студирала психологија на Меѓународниот славјански универзитет во Свети Николе и се стекнала со звањето дипломиран психолог. Професионалната кариера ја започнала во ЈЗУ „Гоце Делчев“ во Македонска Каменица, каде што работела од 1987 до 2006 година. Потоа, во периодот од 2006 до 2017 година работела во приватната здравствена установа „Д-р Драги Фамили Медика“. Во периодот од 2010 до 2014 година, завршила четиригодишна едукација по гештатл психотерапија. Во периодот од 2022 до 2025 година, работи како образовен асистент во локалните училишта во Македонска Каменица и Делчево. Мажена е и мајка на едно дете. Во периодот од 2013 до 2017 година била член на Советот на Општина Македонска Каменица, а во мандатот 2017 -2021 година била градоначалник на општината. На локалните избори во 2025 година, по вторпат ја добила довербата од граѓаните за градоначалник на Општина Македонска Каменица.

**Komuna e MAKEDONSKA KAMENICËS****Kryetar: SONJA STAMENKOVA**

Sonja Stamenkova është lindur më 11 shkurt 1968 në fshatin Sasa, në një familje minerare. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në gjimnazin “Metodija Mitevski – Brico”, drejtimi biologji dhe kimi, ndërsa më pas ka mësuar në shkollën e mesme mjekësore “Veljko Vlahoviç” (sot “Jane Sandanski”) në Shkup, ku ka fituar titullin infermiere. Nga viti 2009 deri në vitin 2012 ka studiuar psikologji në Universitetin Ndërkombëtar Sllavian në Sveti Nikole dhe ka fituar titullin psikolog i diplomuar. Karrierën profesionale e ka nisur në IPSH “Goce Dellçev” në Makedonska Kamenicë, ku ka punuar nga viti 1987 deri në vitin 2006. Më pas, në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2017 ka punuar në institucionin privat shëndetësor “Dr. Dragi Famili Medika”. Në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2014 ka mbaruar një edukim katërvjeçar në psikoterapinë gestalt. Në periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2025 punon si asistent arsimor në shkollat lokale në Makedonska Kamenicë dhe Dellçevë. Është e martuar dhe nënë e një fëmije. Në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka qenë anëtare e Këshillit të Komunës së Makedonska Kamenicës, ndërsa në mandatin e viteve 2017-2021 ka qenë kryetare e komunës. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë ka fituar besimin e qytetarëve si kryetare e Komunës së Makedonska Kamenicës.

Општина МАВРОВО - РОСТУШЕ**ПОВЕРЕНИК од ВЛАДА на РСМ:
ОНЕР ЈАКУПОСКИ**

Онер Јакупоски е роден на 3 мај, 1979 година во Гостивар. Дипломирал на Економски факултет при УКИМ во Скопје. Магистерски студии во областа на екологијата и руралниот туризам завршил на Универзитетот МИТ во Скопје, каде се стекнал со диплома – Магистер по менаџмент на еколошки и рурален туризам. Оженет е и татко на две деца. Добро зборува англиски јазик. Од 2003 – 2007 година бил управител на семејна приватна компанија НОВИТЕТ ПРИНТ ДООЕЛ – Скудриње. Потоа од 2007 – 2017 година бил директор на ЈУ Национален парк Маврово, М. Анови. Од 2018 – 2025 година основал приватна семејна компанија за производство на хартиени опаковки и картонска амбалажа БОС ПАКИНГ ДОО – Скудриње. Од 2009 до 2017 година бил член на Управниот одбор на Асоцијацијата на Национални паркови од Југоисточна Европа и потпретседател на асоцијацијата како национален претставник на Македонија.

**Komuna MAVROVË – ROSTUSHË****I BESUAR nga QEVERIA e RMV-së:
ONER JAKUPOSKI**

Oner Jakuposki është lindur më 3 maj, 1979 në Gostivar. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Studimet e magjistraturës në fushën e ekologjisë dhe turizmit rural i ka përfunduar në Universitetin MIT në Shkup, ku ka fituar diplomën – Master për menaxhimin e turizmit ekologjik dhe rural. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Flet mirë gjuhën angleze. Nga viti 2003 deri në vitin 2007 ka qenë drejtues i kompanisë private familjare NOVITET PRINT DOOEL – Skudrinje. Më pas nga viti 2007 deri në vitin 2017 ka qenë drejtor i NP Parku Kombëtar Mavrovo, Hanet e Mavrovës. Nga viti 2018 deri në vitin 2025 ka themeluar një kompani private familjare për prodhimin e paketave të papirave dhe ambalazheve kartonike BOS PAKING DOO – Skudrinje. Nga viti 2009 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Bordit Drejtues të Asosacionit të Parkeve Kombëtare nga Evropa Juglindore dhe nënkryetar i asosacionit si përfaqësues kombëtar i Maqedonisë.

Општина МАКЕДОНСКИ БРОД

Градоначалник: ЖАРКО РИСТЕСКИ

Жарко Ристески е роден на 15 јуни 1975 година Прилеп. Во 2000 година дипломира на Филозофскиот факултет при УКИМ во Скопје и се стекнал со звање дипломиран социјален работник. Магистрирал на тема „Потребите и капацитетите на згрижувачките семејства, како основен човечки ресурс во процесот на деинституционализацијата“. На Универзитетот за туризам и менаџмент во Скопје, во 2011 година, станал магистер по менаџмент на човечки ресурси. Своео работно искуство го започнал во 2002 година во Министерството за труд и социјална политика, ПЕ Македонски Брод, а од 2005 година работел во ЈУ Меѓуопштински центар за социјална работа - Македонски Брод, каде што во периодот од 2011 до 2017 година бил на раководна позиција на институцијата. Од 2015 до 20017 бил член на Државниот совет за превенција на детско престапништво. Учествовал на меѓународни научно-стручни конференции од оваа област (превенција на детско престапништво), како и на бројни семинари и обуки во областа на социјалната работа, за што се здобил со низа сертификати. Оженет е и татко на две деца. Од 2005 до 2009 и од 2017 до 2021 година бил член на Советот на Општина Македонски Брод, а во периодот од 2008 до 2009 и претседател на Советот. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Македонски Брод.



Komuna e MAKEDONSKI BRODIT

Kryetar: ZHARKO RISTESKI

Zharko Risteski është lindur më 15 qershor 1975 në Prilep. Në vitin 2000 ka diplomuar në Fakultetin Filozofik pranë Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe ka fituar titullin punëtor i diplomuar social. Ka magjistruar me temën “Nevojat dhe kapacitetet e familjeve kujdestare, si burim themelor njerëzor në procesin e deinstitutionalizimit”. Në Universitetin e Turizmit dhe Menaxhimit në Shkup, në vitin 2011 është bërë magjistër në menaxhimin e resurseve njerëzore. Përvojën e tij të punës e ka filluar në vitin 2002 në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, NJR Makedonski Brod, ndërsa nga viti 2005 ka punuar në IP Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale - Makedonski Brod, ku në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2017 ka qenë në pozitë drejtuese të institucionit. Nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Kriminalitetit të Fëmijëve. Ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare shkencore-profesionale në këtë fushë (parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve), si dhe në seminare dhe trajnime të shumta në fushën e punës sociale, për të cilat ka fituar një sërë certifikatash. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Nga viti 2005 deri në vitin 2009 dhe nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Makedonski Brodit, ndërsa në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2009 edhe kryetar i Këshillit. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur për kryetar të Komunës së Makedonski Brodit.

Општина МОГИЛА

Градоначалник:
ДРАГАНЧО САБОТКОВСКИ

Драганчо Саботковски е роден на 11 јуни 1989 година во Битола. По професија е дипломиран економист. Работел како агент за продажба на осигурување и посетувал многу обуки за претприемништво, финансиско работење, мрежен маркетинг и обуки од областа на продажбата и осигурувањето. Поддржувач е на голем број спортски настани во општината и има организирано многубројни хуманитарни акции. Оженет е и има две деца. Активно го користи англискиот јазик. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, ја добил поддршката за градоначалник на Општина Могила.



Komuna e MOGILLËS

Kryetar:
DRAGANÇO SABOTKOVSKI

Draganço Sabotkovski është lindur më 11 qershor 1989 në Manastir. Me profesion është ekonomist i diplomuar. Ka punuar si agjent për shitjen e sigurimeve dhe ka ndjekur shumë trajnime për sipërmarrje, punë financiare, marketing në rrjet dhe trajnime në fushën e shitjes dhe sigurimeve. Është mbështetës i një numri të madh ngjarjesh sportive në komunë dhe ka organizuar shumë aksione humanitare. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Përdor gjuhën angleze në mënyrë angleze. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë ka marrë mbështetje për kryetar të Komunës së Mogillës.

Општина НЕГОТИНО

Градоначалник: МАРИЈА НАЦЕВА

Марија Нацева е родена на 28 октомври 1986 година во Велес. Основно и средно образование завршила во Неготино, а со високо образование се стекнала на Економскиот факултет во Прилеп, при Универзитетот „Св. Климент Охридски“, Битола. Од 2012 година до 2022 година работела во Одделението за финансии и буџет на Општина Неготино. Во март 2023 година, била именувана за секретар на Општина Неготино. Од странските јазици зборува англиски, француски и српски.



Komuna e NEGOTINËS

Kryetar: MARIJA NACEVA

Marija Naceva është lindur më 28 tetor 1986 në Veles. Arsimin fillor dhe atë të mesëm e ka mbaruar në Negotinë, ndërsa ka mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin Ekonomik në Prilep, pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”, Bitola. Nga viti 2012 deri në vitin 2022 ka punuar në Departamentin për financa dhe buxhet në Komunën e Negotinës. Në mars të vitit 2023, është emëruar sekretare e Komunës së Negotinës. Nga gjuhët e huaja flet anglisht, frëngjisht dhe serbisht.

Општина НОВАЦИ

Градоначалник: СТЕВЧЕ СТЕВАНОВСКИ

Стевче Стевановски е роден на 30 мај 1978 година во Битола, а живее во село Добромири, Општина Новаци. Средното образование го завршил во земјоделското училиште во Битола. Дипломирал на Факултетот за земјоделски науки и храна, (поледелска насока) при УКИМ во Скопје и се стекнал со звање дипломиран земјоделски инженер, агроном. Магистранд е на насоката Производство на тутун на Научниот институт за тутун, Прилеп при УКЛО – Битола. Работното искуство го започнал во 2004 година, во земјоделската аптека „Алгозд“, Битола, како советник за хемиска и биолошка заштита и исхрана на растенијата. Во 2008 започнал сопствен бизнис за земјоделско производство. Од 2015 година работи во општинската администрација на Општина Новаци, како советник за локална инфраструктура, сообраќај и заштита на животната средина. Во својот работен век бил член на Управниот одбор на Агенцијата за поттикнување и развој на земјоделството (АПРЗ), на Здружението на граѓани „ПРЕДА“ и член на Надзорниот одбор во Хотел „Молика“ на АД Електрани на Македонија, Скопје. Активно работел на проекти од ИПА фондовите на ЕУ. Бил претседател на Здружението за унапредување и развој на земјоделството „Нова бразда“ Новаци. Оженет е и татко на три деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Новаци.



Komuna e NOVACIT

Kryetar: STEVÇE STEVANOVSKI

Stevçe Stevanovski është lindur më 30 maj 1978 në Manastir, ndërsa jeton në fshatin Dobromiri, Komuna e Novacit. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në shkollën bujqësore në Manastir. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit (dega bujqësore) pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe ka fituar titullin inxhinier i diplomuar bujqësor, agronom. Është magjistrant në degën Prodhimi i duhanit në Institutin Shkencor të Duhanit, Prilep pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir. Përvojën e punës e ka filluar në vitin 2004, në farmacinë bujqësore “Algozd”, Manastir, si këshilltar për mbrojtjen kimike dhe biologjike dhe ushqimin e bimëve. Në vitin 2008 ka filluar një biznes të tij për prodhimin bujqësor. Që nga viti 2015 punon në administratën komunale të Komunës së Novacit, si këshilltar për infrastrukturën lokale, qarkullimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Gjatë karrierës së tij ka qenë anëtar i Bordit Drejtues të Agjencisë për Nxitjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë (ANZHB), i Shoqatës së qytetarëve “PREDA” dhe anëtar i Bordit Mbikëqyrës në hotel “Molika” të SHA Elektraneve të Maqedonisë, Shkup. Ka punuar në mënyrë aktive në projekte nga fondet IPA të BE-së. Ka qenë kryetar i Shoqatës për përmirësimin dhe zhvillimin e bujqësisë “Nova brazda” në Novac. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur si kryetar i Komunës së Novacit.

Општина НОВО СЕЛО

Градоначалник: ЃОРЃЕ БОЖИНОВ

Ѓорѓе Божинов е роден на 16 август 1992 година во Ново Село. Дипломирал на Економскиот факултет, а во 2013 продолжил на постдипломски студии за бизнис-менаџмент, каде што се стекнал со титулата магистер. Низ своето образование посетувал бројни меѓународни школи за економија, бизнис и политика. Во 2014 година учествувал на Школата за пазар на капитал и финансиски системи во Цетиње (Црна Гора). Во 2015 година станал дел од Меѓународната школа за млади лидери под покровителство на Претседателот на Република Македонија, проф. д-р Ѓорге Иванов. Во 2022 година учествувал на Меѓународната школа за млади политички лидери во Вашингтон, САД, организирана од Американскиот совет за млади политички лидери, по препорака на американската амбасада во нашата земја. Во 2024 година учествувал и на Меѓународната школа за млади политички лидери организирана од Европската Унија, во Брисел. Женет е и татко на едно дете. На локалните избори во октомври 2025 година, последователно, по вторпат ја добил довербата од граѓаните за вршење на функцијата градоначалник на Општина Ново Село.



Komuna e NOVO SELLËS

Kryetar: GJORGJE BOZHINOV

Gjorgje Bozhinov është lindur më 16 gusht 1992 në Novo Sellë. Ka diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, ndërsa në vitin 2013 ka vazhduar studimet pasuniversitare për menaxhimin e biznesit, ku ka fituar titullin magjistër. Gjatë arsimimit të tij ka ndjekur shumë shkolla ndërkombëtare për ekonomi, biznes dhe politikë. Në vitin 2014 ka marrë pjesë në Shkollën për tregun e kapitalit dhe sistemet financiare në Cetinje (Mal i Zi). Në vitin 2015 është bërë pjesë e Shkollës Ndërkombëtare për Liderë të Rinj nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, prof. dr. Gjorgje Ivanov. Në vitin 2022 ka marrë pjesë në Shkollën Ndërkombëtare për Liderë Politike të Rinj në Uashington, SHBA, e organizuar nga Këshilli Amerikan për Liderë të Rinj Politikë, sipas rekomandimit të Ambasadës Amerikane në vendin tonë. Në vitin 2024 ka marrë pjesë gjithashtu në Shkollën Ndërkombëtare për Liderë të Rinj Politikë, të organizuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel. Është i martuar dhe baba i një fëmije. Në zgjedhjet lokale të tetorit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës së Novo Sellës.

Општина ОХРИД

Градоначалник: КИРИЛ ПЕЦАКОВ

Кирил Пецаков е роден на 6 јули 1985 во Охрид. Основно и средно образование завршил во Охрид, а со високо образование се стекнал на Стоматолошкиот факултет „Св. Пантелејмон“ при УКИМ, Скопје. Специјализирал на Стоматолошкиот факултет и се стекнал со звање специјалист по детска и превентивна стоматологија. Оженет е и татко на две деца. Во два мандата (2009 – 2013 и 2017 – 2020) бил член на Советот на Општина Охрид, а во периодот од 2020 до 2021 година бил пратеник во Собранието на РСМ. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, е избран за градоначалник на Општина Охрид.



Komuna e OHRIT

Kryetar: KIRILL PECAKOV

Kiril Pecakov është lindur më 6 korrik 1985 në Ohër. Arsimin fillor dhe atë të mesëm e ka mbaruar në Ohër, ndërsa arsimin e lartë në Fakultetin Stomatologjik “Shën Pantelejmon” pranë Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup. Ka specializuar në Fakultetin Stomatologjik në Shkup dhe ka fituar titullin specialist në stomatologji të fëmijëve dhe atë preventive. Në dy mandatet (nga viti 2009 deri në vitin 2013 dhe nga viti 2017 deri në vitin 2020) ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Ohrit. Nga viti 2020 deri në tetor 2021 ishte deputet në Kuvendin e RMV-së. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur për kryetar të Komunës së Ohrit.

Општина ПЕТРОВЕЦ

Градоначалник: БОРЧЕ МИТЕВСКИ

Борче Митевски е роден на 6 август 1961 година. Живее во општината Петровец. По професија е економист. Првото работно место во 1980 година му било маркетинг контрола во АД „ЗЕМ Промет“, а потоа до 2008 година работел во ЈПАУ Македонија – Аеродром „Александар Велики“ како шеф на службата за физичко обезбедување. Како поранешен спортист, слободното време го користи за спортско рекреирање, особено за играње кошарка. На локалните избори во 2025 година, жителите на општината, последователно, по петти пат, му ја довериле функцијата градоначалник на Општина Петровец.



Komuna e PETROVECIT

Kryetar: BORÇE MITEVSKI

Borçe Mitevski është lindur më 6 gusht 1961. Jeton në Komunën e Petrovecit. Me profesion është ekonomist i diplomuar. Përvoja e tij e parë e punës në vitin 1980 ka qenë kontrolli i marketingut në S.H.A. “ZEM Promet”, e më pas deri në vitin 2008 në NPSHA Maqedoni - Aeroporti “Aleksandri i Madh”, si shef i shërbimit të sigurisë fizike. Si ish-sportist, kohën e lirë e shfrytëzon për rekreacion sportiv, veçanërisht për të luajtur basketboll. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, banorët e komunës, për herë të pestë radhazi, ia kanë besuar funksionin e kryetarit të Komunës së Petrovecit.

Општина ПЕХЧЕВО

Градоначалник: АЛЕКСАНДАР КИТАНСКИ

Александар Китански е роден на 25 јули 1978 година во Кочани. Основно образование завршил во Пехчево, а средно образование во СУГС „Браќа Миладиновци“ – Скопје како ветеринарен техничар. Дипломирал на Факултетот за ветеринарна медицина – Скопје и се стекнал со звање доктор по ветеринарна медицина. Работното искуство во својата професија, од 2011 година па сè до 2021 година, го реализирал во ДОО Ветеринарна станица „Бе – Вет“ Берово. Учествовал на повеќе семинари и курсеви и активно ги користи информатичко-комуникациските технологии. Тој е семеен човек, сопруг и татко на едно дете. Од 2017 до 2021 година бил член на Советот на Општина Пехчево. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, ја добил довербата од граѓаните за градоначалничката функција за Општина Пехчево.



Komuna e PEHÇEVËS

Kryetar: ALEKSANDAR KITANSKI

Aleksandar Kitanski është lindur më 25 korrik 1978 në Koçan. Arsimin fillor e ka mbaruar në Pehçevë, ndërsa arsimin e mesëm në SHMQSH “Vëllezërit Miladinovci” – Shkup si teknik veterinar. Ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare – Shkup dhe ka fituar titullin doktor për mjekësi veterinare. Përvojën e punës në profesionin e tij, nga viti 2011 deri në vitin 2021, e ka realizuar në SHPK Stacioni Veterinar “Be – Vet” Berovë. Ka marrë pjesë në shumë seminare dhe kurse dhe përdor teknologjitë informatike-komunikuese në mënyrë aktive. Ai është një njeri familjar, bashkëshort dhe baba i një fëmije. Nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Pehçevës. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për funksionin e kryetarit të Komunës së Pehçevës.

Општина ПЛАСНИЦА

Градоначалник: АЛИЈА ЈАОСКИ

Алија Јаоски е роден на 10 јануари 1968 година во село Пласница. Основно училиште завршил во родното место, а дипломирал на Економскиот факултет. Зборува повеќе странски јазици, меѓу кои турски и германски. Спортувањето му е омилена рекреација. На вонредните локални избори за оваа општина, на 13 декември 2020 година, за првпат бил избран за градоначалник на општината. Повторно ја добил довербата од населението за мандатот за градоначалник (2021 – 2025 година), како и по третпат, за мандатот 2025 – 2029 година.



Komuna e PLLASNICËS

Kryetar: ALIJA JAOSKI

Alija Jaoski është lindur më 10 janar 1968 në fshatin Plassnicë. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik. Flet disa gjuhë të huaja, duke përfshirë turqishten dhe gjermanishten. Sporti është rekreacioni i tij i preferuar. Në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për këtë komunë, më 13 dhjetor 2020, u zgjodh për herë të parë kryetar i komunës. Përsëri ka fituar besimin e popullsisë për mandatin si kryetar (vitet 2021 – 2025), si dhe për herë të tretë, për mandatin e viteve 2025 – 2029.

Општина ПРИЛЕП

Градоначалник: ДЕЈАН ПРОДАНОСКИ

Дејан Проданоски е роден на 14 април 1981 година во Прилеп, каде што завршил основно и средно образование. Се школувал на Техничкиот факултет, при Универзитетот „Св. Климент Охридски“, Битола и во 2006 година се стекнал со звањето дипломиран сообраќаен инженер. Работното искуство го започнал во 2008 година, во Државниот архив на Република Македонија – Одделение Прилеп. Во периодот од 2012 до 2017 година бил раководител на Одделението на Државниот архив на Македонија во Прилеп. Зборува англиски и германски јазик. Оженет е и татко на три деца. Активно учествувал во општествениот живот на локално ниво, а во периодот 2017 – 2021 година бил член на Советот на Општина Прилеп. Во периодот 2021 – 2024 година бил претседател на Советот на Општината.



Komuna e PRILEPIT

Kryetar: DEJAN PRODANOSKI

Dejan Prodanoski është lindur më 14 prill 1981 në Prilep, ku ka mbaruar arsimin fillor dhe atë të mesëm. Ai ka studiuar në Fakultetin Teknik pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”, Manastir dhe në vitin 2006 ka fituar titullin inxhinier i diplomuar për trafik. Përvojën e punës e ka filluar në vitin 2008, në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë – Departamenti Prilep. Në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2017 ka qenë udhëheqës i Departamentit të Arkivit Shtetëro të Maqedonisë në Prilep. Flet gjuhën angleze dhe gjermane. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën shoqërore në nivel lokal, ndërsa në periudhën e viteve 2017 – 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Prilepit. Në periudhën e viteve 2021 – 2024 ka qenë kryetar i Këshillit të Komunës.

Општина ПРОБИШТИП

Градоначалник: ТОНИ ТОНЕВСКИ

Тони Тоневски е роден во Пробиштип. Дипломирал на Рударско-геолошкиот факултет при Универзитетот „Гоце Делчев“ – Штип, во 1997 година. Својата кариера ја започнал како рударски инженер во рудникот за олово и цинк „Злетово“, каде што во 2002 година станал генерален директор на компанијата. Од 2006 до 2008 година бил претседател на Управниот одбор и проект-менаџер во ЈП „Хидросистем Злетовица“, а потоа бил директор на Управата за водостопанство при Министерството за земјоделство, шумарство и водостопанство. Во 2024 година бил назначен за директор на компанијата „Булмак 2016“, каде што работел на развојни и индустриски иницијативи поврзани со рударството и локалниот економски развој. Професионално се усовршувал следејќи повеќе специјализирани обуки за менаџмент и хидрологија во Франција и Чешка. Активно зборува англиски јазик. Оженет е и татко на две деца. Во периодот од 2009 до 2013 и од 2013 до 2017 година, во два мандата, бил градоначалник на Општина Пробиштип. Повторно се кандидирал на локалните избори во 2025 година и по третпат ја добил довербата од граѓаните.



Komuna e PROBISHTIPIT

Kryetar: TONI TONEVSKI

Toni Tonevski është lindur në Probishtip. Ka diplomuar në Fakultetin për Miniera dhe Gjeologji pranë Universitetit “Goce Delchev” – Shkup, në vitin 1997. Karrierën e tij e ka filluar si inxhinier minerar në minierën për plumb dhe zink “Zletovo”, ku në vitin 2002 është bërë drejtor i përgjithshëm i kompanisë. Nga viti 2006 deri në vitin 2008 ka qenë kryetar i Bordit Drejtues dhe menaxher projekti në NP “Hidrosistem Zletovica”, ndërsa më pas ka qenë drejtor i Drejtorisë për Ekonominë e Ujërave pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Në vitin 2024 është emëruar drejtor i kompanisë “Bulmak 2016”, ku ka punuar për iniciativa zhvillimore dhe industriale të lidhura me minierat dhe zhvillimin ekonomik lokal. Profesionalisht është përmirësuar duke ndjekur më shumë trajnime të specializuara për menaxhimin dhe hidrologjinë në Francë dhe Çeki. Flet gjuhën angleze në mënyrë aktive. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2013 dhe nga viti 2013 deri në vitin 2017, në dy mandate, ka qenë kryetar i Komunës së Probishtipit. Përsëri u kandidua në zgjedhjet lokale të vitit 2025 dhe për herë të tretë ka fituar besimin e qytetarëve.

Општина РАДОВИШ

Градоначалник: ЛЈУПЧЕ ПОЧИВАЛЕЦ

Љупче Почивалец е роден на 23 август 1981 година во Радовиш. Со високо образование се стекнал на Правниот факултет „Јустинијан Први“ при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје и станал дипломиран правник. Професионалната кариера ја започнал со стажирање во Основниот суд во Радовиш, каде што се стекнал со практични искуства во примена на законите и функционирањето на правосудниот систем. Потоа работел во Агенцијата за катастар на недвижности, па во Јавното претпријатие „Македонски шуми“, каде што ја извршувал и функцијата раководител на подружницата ПШС „Плачковица“. Активно зборува англиски јазик. Оженет е и татко на две деца. Во 2021 година бил избран за член на Советот на Општина Радовиш, а истата година бил именуван и за секретар на Општина Радовиш.



Komuna e RADOVISHIT

Kryetar: LJUPČE POČIVALEC

Ljupče Počivalec është lindur më 23 gusht 1981 në Radovich. Arsimin e lartë e ka mbaruar në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe është bërë jurist i diplomuar. Karrierën profesionale e ka filluar me praktikë në Gjykatën Themelore në Radovich, ku ka fituar përvojën praktike në zbatimin e ligjeve dhe funksionimin e sistemit gjyqësor. Pastaj ka punuar në Agjencinë për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme, pastaj në Ndërmarrjen Publike “Pyjet e Maqedonisë”, ku ka ushtruar edhe funksionin e udhëheqësit të degës DEP “Pllaçkovicë”. Flet gjuhën angleze në mënyrë aktive. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në vitin 2021 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës së Radovishit, ndërsa në të njëjtin vit është emëruar gjithashtu sekretar i Komunës së Radovishit.

Општина РАНКОВЦЕ

Градоначалник: ДАНИЕЛ ПАВЛОВСКИ

Даниел Павловски е роден на 27 мај 1994 година во Крива Паланка. Основното образование го завршил во Ранковце, а средното во Крива Паланка. Дипломирал на Правниот факултет „Јустинијан Први“ при УКИМ, каде што запишал и магистратура насочена кон административното право и јавната администрација. Работната кариера ја започнал во приватниот сектор, а подоцна се вработил во Царинска управа, каде што професионално се усовршувал во областа на стоковиот промет и административните процеси. Во периодот од 2021 до 2025 година бил член на Советот на Општина Ранковце. Во слободно време сака да чита книги и да стекнува нови знаења и личен напредок.



Komuna e RANKOVČES

Kryetar: DANIELL PAVLOVSKI

Daniell Pavlovski është lindur më 27 maj 1994 në Kriva Pallankë. Arsimin fillor e ka mbaruar në Rankovcë, ndërsa atë të mesëm në Kriva Pallankë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, ku është regjistruar për magjistraturë në drejtim të së drejtës administrative dhe administratës publike. Karrierën e tij profesionale e ka nisur në sektorin privat, ndërsa më vonë është punësuar në Drejtorinë e Doganave, ku është specializuar në fushën e tregtisë së mallrave dhe proceseve administrative. Në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2025 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Rankovcës. Në kohën e lirë i pëlqen të lexojë libra dhe të fitojë njohuri të reja dhe përparim personal.

Општина РЕСЕН

Градоначалник: **ЈОВАН ТОЗИЕВСКИ**

Јован Тозиевски е роден на 4 септември 1983 година во Битола. Тој е дипломиран економист со долгогодишно искуство во јавниот сектор и локалната самоуправа. Својата кариера ја започнал како волонтер во Министерството за земјоделство, шумарство и водостопанство – подрачна единица Ресен, а потоа работел во Јавното комунално претпријатие „Пролетер“ – Ресен. Активно зборува англиски јазик. Негово хоби е скијањето. Оженет е и татко на три деца. Во периодот од 2013 до 2021 година, бил член на Советот на Општина Ресен. На локалните избори во октомври 2025 година, последователно, по вторпат, ја добил довербата од граѓаните да ја извршува градоначалничката функција на Општина Ресен.



Komuna e RESNJËS

Kryetar: **JOVAN TOZIEVSKI**

Jovan Tozievski është lindur më 4 shtator 1983 në Manastir. Ai është ekonomist i diplomuar me përvojë të gjatë në sektorin publik dhe vetëqeverisjen lokale. Karrierën e tij e ka filluar si vullnetar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave – njësia rajonale Resnjë, ndërsa më pas ka punuar në Ndërmarrjen Publike Komunale “Proleter” – Resnjë. Flet gjuhën angleze në mënyrë aktive. Hobin e tij e ka skijimin. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2021 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Resnjës. Në zgjedhjet lokale të tetorit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e qytetarëve për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës së Resnjës.

Општина РОСОМАН

Градоначалник: **ЃОРЃИ КРСТЕВСКИ**

Ѓорѓи Крстевски е роден на 5 март 1989 година. Тој е дипломиран машински инженер и магистер по индустриски менаџмент. Својата професионална кариера ја започнал во Општина Росоман, во 2011 година, каде што работел во Одделението за локален економски развој. Во овој период активно учествувал во подготовка и реализација на бројни проекти од областа на инфраструктурата, земјоделството и одржливиот локален развој. Во периодот од 2022 до 2024 година бил ангажиран во Општина Неготино, како советник во Одделението за локален економски развој. Од 2024 до 2025 година бил дел од Канцеларијата на Претседателот на Владата на Република Северна Македонија, каде што ја извршувал функцијата советник за локална самоуправа. Оженет е и татко на едно дете.



Komuna e ROSOMANIT

Kryetar: **GJORGJI KËRSTEVSKI**

Gjorgji Kërstevski është lindur më 5 mars 1989. Ai është inxhinier i diplomuar mekanik dhe magjistër për menaxhimin industrial. Karrierën e tij profesionale e ka nisur në Komunën e Rosomanit në vitin 2011, ku ka punuar në Departamentin për zhvillimin ekonomik lokal. Gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në përgatitjen dhe realizimin e shumë projekteve në fushën e infrastrukturës, bujqësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Nga viti 2022 deri në vitin 2024 ka qenë i angazhuar në Komunën e Negotinës, si këshilltar në Departamentin për zhvillimin ekonomik lokal. Nga viti 2024 deri në vitin 2025 ka qenë pjesë e Zyrës së Presidentit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku ka ushtruar funksionin e këshilltarit për vetëqeverisjen lokale. Ai është i martuar dhe baba i një fëmije.

Општина СВЕТИ НИКОЛЕ

Градоначалник: **ДЕЈАН ВЛАДЕВ**

Дејан Владев е роден на 10 јуни 1975 година во Свети Николе. Дипломирал на Правниот факултет „Јустинијан Први“ при УКИМ, во Скопје. Својата професионална кариера ја започнал во приватниот сектор, како правник, а подоцна работел како раководител во Агенцијата за вработување во Свети Николе. Активно зборува англиски и српски јазик. Во слободното време ужива во спортот, читањето и пешачењето. Оженет е и татко на две деца. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат ја добил довербата од населението за градоначалник на Општина Свети Николе.



Komuna e SVETI NIKOLLËS

Kryetar: **DEJAN VLLADEV**

Dejan Vlladev është lindur më 10 qershor 1975 në Sveti Nikollë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, në Shkup. Karrierën e tij profesionale e nisi në sektorin privat, si jurist, ndërsa më vonë ka punuar si udhëheqës në Agjencinë për Punësim në Sveti Nikollë. Flet gjuhën angleze dhe serbe në mënyrë aktive. Në kohën e lirë ai gëzohet me sport, lexim dhe ecje. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, ka fituar besimin e popullatës si kryetar i Komunës së Sveti Nikollës.

Општина САРАЈ

Градоначалник: МУХАМЕД ЕЛМАЗИ

Мухамед Елмази е роден на 31 март 1989 година. Завршил средно економско училиште во Скопје, а потоа дипломирал на Економскиот факултет на Државниот универзитет во Тетово. Оженет е и татко на пет деца. Бил член на Советот на Општина Сарај во периодот од 2017 до 2021 година, а потоа во периодот од 2021 до 2024 година бил член на Советот на Град Скопје. Во 2024 година ја презел функцијата на генерален директор на Акционерското друштво за вршење енергетска дејност, пренос на природен гас НОМАГАС, каде што работел сè до изборот за градоначалник, на локалните избори во октомври 2025 година.



Komuna e SARAJIT

Kryetar: MUHAMED ELMAZI

Muhamed Elmazi është lindur më 31 mars 1989. Ka mbaruar shkollën e mesme ekonomike në Shkup, ndërsa më pas ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Është i martuar dhe baba i pesë fëmijëve. Ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Sarajit në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2021, dhe më pas në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2024 ka qenë anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit. Në vitin 2024 ka marrë funksionin e drejtorit të përgjithshëm të Shoqatës aksionare për ushtrimin e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS, ku ka punuar deri në zgjedhjen për kryetar të komunës në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2025.

Општина СОПИШТЕ

Градоначалник: ЈАНЕ МИЦЕВСКИ

Јане Мицевски е роден на 26 декември 1988 година. По завршувањето на високото образование продолжил со стручно усовршување и станал магистер по менаџмент на човечки ресурси. Зборува активно англиски јазик. Во периодот од 2013 до 2017 година бил член на Советот на Општина Сопиште, а потоа во периодот од 2017 до 2021 година бил и негов претседател. Кариерата ја продолжил во јавниот сектор и бил назначен за директор на ЈП Депонија „Дрисла“ (2021 – 2022). Во периодот од 2023 до 2024 година ја извршувал функцијата директор на Центарот за развој на Скопскиот Плански Регион, со акцент на регионалниот развој, стратешко планирање и координација на проектите од регионално значење. На парламентарните избори во 2024 година бил избран за пратеник во Собранието на РСМ, каде што активно учествувал во работата на Комисијата за финансирање и буџет и Комисијата за локална самоуправа.



Komuna e SOPISHTIT

Kryetar: JANE MICEVSKI

Jane Micevski është lindur më 26 dhjetor 1988. Pas mbarimit të arsimit të lartë, ka vazhduar me specializim profesional dhe është bërë magjistër për menaxhimin e resurseve njerëzore. Flet gjuhën angleze në mënyrë aktive. Në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Sopištit, ndërsa më pas në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka qenë edhe kryetar i saj. Karrierën e ka vazhduar në sektorin publik dhe është emëruar drejtor i NP Deponia “Drisla” (2021 – 2022). Në periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2024 ka ushtruar funksionin e drejtorit të Qendrës për Zhvillimin e Rajonit Planifikues të Shkupit, me theks në zhvillimin rajonal, planifikimin strategjik dhe koordinimin e projekteve me rëndësi rajonale. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 u zgjodh deputet në Kuvendin e RMV-së, ku mori pjesë në mënyrë aktive në punën e Komisionit për financim dhe buxhet dhe Komisionit për vetëqeverisje lokale.

Општина СТРУМИЦА

Градоначалник: ПЕТАР ЈАНКОВ

Петар Јанков е роден на 13 јануари 1976 година во Струмица, каде што завршил основно и средно образование. Дипломирал на Факултетот за туризам и угостителство - Охрид при Универзитетот „Свети Климент Охридски“, во Битола, како менаџер по царина и шпедиција. Од 2007 година работел во Царинската управа на позиција виш цариник. Во 2018 година ја напуштил јавната служба и продолжил да работи во приватниот сектор. Оженет е и татко на две деца.



Komuna e STRUMICËS

Kryetar: PETAR JANKOV

Petar Jankov është lindur më 13 janar 1976 në Strumicë, ku ka mbaruar arsimin fillor dhe atë të mesëm. Ka diplomuar në Fakultetin e Turizmit dhe Hotelerisë - Ohër pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”, në Manastir, si menaxher për doganë dhe transport mallrash. Që nga viti 2007 ka punuar në Drejtorinë e Doganave në pozita si doganier i lartë. Në vitin 2018 e ka lënë shërbimin publik dhe ka vazhduar të punojë në sektorin privat. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Општина СТАРО НАГОРИЧАНЕ

Градоначалник:
МИРОСЛАВ СЛАВКОВСКИ

Мирослав Славковски е роден на 20 април 1985 година, во Куманово, а живее во село Младо Нагоричане. Средно образование завршил во СУГС „Владо Тасевски“ Скопје. Дипломирал на Техничкиот факултет во Битола, во 2009 година, и се стекнал со звање дипломиран сообраќаен инженер. Целиот работен век, од 2009 година до изборот за градоначалник го поминал во Општина Старо Нагоричане, во Одделението за урбанизам. Има основно познавање на англискиот јазик. Не е оженет. Повеќе од 10 години учествувал во хуманитарни акции на здруженија, а особено бил активен при организирање на крводарителски акции во општината, во соработка со Црвен крст Куманово.



Komuna e NAGORIÇIT TË VJETËR

Kryetar:
MIROSLAV SLLAVKOVSKI

Mirosllav Sllavkovski është lindur më 20 prill 1985, në Kumanovë, ndërsa jeton në fshatin Nagoriçin e Ri. Arsimimin e mesëm e ka mbaruar në SHMQSH “Vllado Tasevski” në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Teknik në Manastir, në vitin 2009 dhe ka fituar titullin inxhinier i diplomuar për trafik. Të gjithë jetën e tij profesionale, nga viti 2009 deri në zgjedhjen e tij për kryetar komune, e ka kaluar në Komunën e Nagoriçit të Vjetër, në Departamentin e Urbanizmit. Ka njohuri bazë për gjuhën angleze. Nuk është i martuar. Më shumë se 10 vjet ka marrë pjesë në aksione humanitare të shoqatave dhe veçanërisht ka qenë aktiv në organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në komunë, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kumanovës.

Општина СТРУГА

Градоначалник: МЕНДИ КУРА

Менди Кура е роден на 19 февруари, 1960 година во селото Бицево, Општина Струга. Дипломирал на Факултетот за земјоделство при Универзитетот во Приштина, а постдипломските студии ги завршил во Загреб. Во текот на својата кариера извршувал значајни раководни функции. Бил директор на хотелот „Изгрев“ во Струга, како и на осигурителната компанија „Signa Insurance“. Во бизнис-секторот се истакнал и како коосновач и член на Сеалбанскиот економски форум. Една од најзначајните функции е позицијата претседател на Стопанската комора на Северо-Западна Македонија. Покрај ангажманот во бизнис секторот, познат е и по своето активно учество во општествени и спортски проекти. Тој е основач и претседател на Ф.К. „Струга“. Кура е исто така основач и извршен директор на компанијата „Trim & Lum“, основач на хотелот и СПА-центарот „Ëmbla“, а од 2 ноември 2025 година ја извршува функцијата градоначалник на Општина Струга. Познат е и по својот филантропски ангажман и поддршката на оние на кои им е најпотребно, особено на семејствата од ранливи социјални категории и на децата со посебни потреби.



Komuna e STRUGËS

Kryetar: MENDI QYRA

Mendi Qyra është lindur më 19 shkurt 1960 në fshatin Bixhovë, Strugë. Ka diplomuar në Fakultetin e Agronomisë pranë Universitetit të Prishtinës, ndërsa ka përfunduar edhe studimet pasuniversitare në Zagreb. Në karrierën e tij ka mbajtur pozita të rëndësishme udhëheqëse: ka qenë drejtor i Hotelit “Izgrev” në Strugë dhe i kompanisë së sigurimeve “Signa Insurance”. Në sektorin e biznesit është dalluar edhe si bashkëthemelues dhe anëtar i Forumit Ekonomik Mbarë Shqiptar. Funksionin më të rëndësishëm e konsideron atë të Kryetarit të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore. Përveç angazhimit në biznes, është i njohur edhe për pjesëmarrjen e tij aktive në projekte shoqërore dhe sport. Ai është themelues dhe President i KF “Struga”. Qyra është gjithashtu themelues dhe drejtor ekzekutiv i kompanisë “Trim & Lum”, themelues i Hotel & SPA “Ëmbla” dhe që nga 2 nëntori 2025, Kryetar i Komunës së Strugës. Ai është i njohur për kontributin e tij filantropik dhe mbështetjen e qytetarëve në nevojë, sidomos familjeve nga kategoritë sociale të rënda dhe fëmijëve me nevoja të veçanta.

Општина СТУДЕНИЧАНИ

Градоначалник: ЕЈУП АБАЗИ

Ејуп Абази е роден на 4 април 1976 година, во Студеничани. Со звањето магистер по филозофија на религијата се стекнал на Универзитетот „Улудаг“ во Бурса, Турција. Во периодот 2004 – 2009 година работел како социолог во СОУ. „Наим Фрашери“ во село Студеничани. Од 2010 до 2021 година бил раководител на Одделението за човечки ресурси во Општина Студеничани, а од 2022 година работел во Инспекторатот за употреба на јазиците, повторно како раководител на Одделението за човечки ресурси.



Komuna e STUDENIÇANIT

Kryetar: EJUP ABAZI

Ejup Abazi është lindur më 4 prill 1976, në Studenichan. Titullin magjistër për filozofinë e religjionit e ka fituar në Universitetin “Uludag” në Bursë, Turqi. Në periudhën e viteve 2004 – 2009 ka punuar si sociolog në SHMK “Naim Frashëri” në fshatin Studenichan. Nga viti 2010 deri në vitin 2021 ka qenë drejtor i Departamentit të resurseve njerëzore në Komunën e Studenichanit, ndërsa nga viti 2022 ka punuar në Inspektoratin për përdorimin e gjuhëve, përsëri si udhëheqës i Departamentit të resurseve njerëzore.

Општина ТЕАРЦЕ

Градоначалник: ДАУТ МЕМИШИ

Даут Мемиши е роден на 13 февруари, 1990 година, во село Слатина. Во 2020 година дипломирал бизнис-администрација. Од февруари 2015 година до јули 2021 година бил управител на приватна компанија. Од февруари 2021 година до октомври 2023 година бил заменик-директор на ЈКП „Тетово“, Тетово. Од октомври 2023 година до јули 2024 година бил директор на Општинското претпријатие за управување со отпад „Саубермахер“, Тетово. Од јули 2024 до октомври 2025 година бил директор на Бирото за регионален развој. Зборува одлично англиски јазик. Оженет е и татко на две деца. Во слободното време сака да патува, да скија и да чита.



Komuna e TEARCËS

Kryetar: DAUT MEMISHI

Daut Memishi është lindur më 13 shkurt 1990 në fshatin Sllatinë. Në vitin 2020 ka diplomuar në degën administratë e biznesit. Nga shkurti i vitit 2015 deri në korrik të vitit 2021 ka qenë menaxher i një kompanie private. Nga shkurti i vitit 2021 deri në tetor të vitit 2023 ka qenë zëvendës-drejtor i NKP “Tetova”, Tetovë. Nga tetori i vitit 2023 deri në korrik të vitit 2024 ka qenë drejtor i Ndërmarrjes Publike për Menaxhimin e Mbeturinave “Saubermaher”, Tetovë dhe nga korriku i vitit 2024 deri tetor 2025 ka qenë drejtor i Byrosë për Zhvillim Rajonal. Flet gjuhën angleze në mënyrë të shkëlqyeshme. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. I pëlqen të lexojë, të skijojë, të udhëtojë.

Општина ЧУЧЕР САНДЕВО

Градоначалник: ЗОРАН БАЈОВСКИ

Зоран Бајовски основно образование завршил во Сандево, средно во СМУГС „Д-р Панче Караџов“ во Скопје, а потоа станал дипломиран радиолошки технолог. Седумнаесет години работел на Клиниката за радиотерапија и онкологија. Во 2024 година бил назначен за директор на Дирекцијата за радијациона сигурност. Во периодот 2013 – 2017 година бил член и претседател на Советот на Општина Чучер Сандево, а член на Советот бил и во периодот 2021 – 2024 година.



Komuna e ÇUÇER SANDEVËS

Kryetar: ZORAN BAJOVSKI

Zoran Bajovski e ka mbaruar arsimin fillor në Sandevë, atë të mesëm në SHMMQSH “Dr. Pançe Karagjozov” në Shkup, dhe me pas ka fituar titullin teknolog i diplomuar në radiologji. Ka punuar për shtatëmbëdhjetë vjet në Klinikën për radioterapi dhe onkologji. Në vitin 2024 është emëruar drejtor i Drejtorisë për sigurinë radiologjike. Në periudhën e viteve 2013 – 2017 ka qenë anëtar dhe kryetar i Këshillit të Komunës së Çuçer Sandevës, ndërsa anëtar i Këshillit ka qenë edhe në periudhën e viteve 2021 – 2024.

Општина ТЕТОВО

Градоначалник: БИЉАЛ КАСАМИ

Биљал Касами е роден на 31 јули 1975 година во Тетово. Во 2000 година дипломира економија на Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје. На истиот Универзитет, во 2011 година ги завршил докторските студии, со што се стекнал со титулата доктор на економски науки. Од 2000 до 2004 година работел во Царинската управа на РСМ. Во периодот од 2005 до 2006 година бил државен секретар во Министерството за економија на РСМ, од каде, по завршувањето на мандатот во 2006 година, се вратил на работното место во Царинската управа каде останал сè до 2008 година. Од 2009 до 2014 година бил професор на Балканскиот меѓународен универзитет, по што се повлекол за да ѝ се посвети на политиката. Својата академска кариера ја продолжил од 2017 година, како професор на повеќе универзитети во Република Косово, а ангажманот го продолжил како редовен професор на Универзитетот „Дарданија“. Оженет е и татко на три деца. На парламентарните избори во декември 2016 година бил избран за пратеник во Собранието на РМ, сè до 2017 година кога поднел оставка за да се кандидира за градоначалник на Општина Тетово. На предвремените парламентарни избори, на 15 јули 2020 година, бил избран за пратеник во Собранието на РСМ. На локалните избори во октомври 2025 година, последователно, по вторпат, населението му ја дало довербата да ја извршува градоначалничката функција за Општина Тетово.



Komuna e TETOVËS

Kryetar: BILALL KASAMI

Bilall Kasami është lindur më 31 korrik 1975, në Tetovë. Në vitin 2000 ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Në të njëjtin universitet, në vitin 2011 ka mbaruar studimet e doktorit duke fituar titullin doktor i shkencave ekonomike. Në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2004 ka punuar në Drejtorinë e Doganave të RMV-së. Në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2006 ka qenë sekretar shtetëror në Ministrinë e Ekonomisë e RMV-së, prej nga, pas përfundimit të mandatit në vitin 2006 është kthyer në vendin e punës në Drejtorinë e Doganave, ku ka mbetur deri në vitin 2008. Nga viti 2009 deri në vitin 2014 ka qenë profesor të Universitetit Ballkanik Ndërkombëtar dhe pastaj është tërhequr për t’iu kushtuar politikës. Karrierën e tij akademike e ka vazhduar në vitin 2017, si profesor i më shumë universiteteve në Republikën e Kosovës, ndërsa angazhimin e tij e ka vazhduar si profesor i rregullt në Universitetin “Dardania”. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve. Në zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2016 është zgjedhur për deputet në Kuvendin e RM-së, ku ka qëndruar deri më vitin 2017, kur ka dhënë dorëheqje për t’u kandiduar për kryetar të Komunës së Tetovës. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 15 korrik 2020 është zgjedhur për deputet në Kuvendin e RMV-së. Në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, popullata ia ka dhënë besimin për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës së Tetovës.

Општина ЦЕНТАР

Градоначалник: ГОРАН ГЕРАСИМОВСКИ

Горан Герасимовски е роден на 9 јануари 1982 година. Дипломира социологија, а потоа магистрирал менаџмент на човечки ресурси, стекнувајќи напредни знаења во организациски развој и управување со јавни институции. Професионалната кариера ја започнал во Државниот завод за статистика (2006 – 2008), каде што работел на подготовка и координација на статистички истражувања. Од 2009 до 2017 година бил активен во приватниот сектор, управувајќи со проекти од областа на јавни истражувања, аналитика и комуникации. Во 2017 година бил назначен за заменик-директор, а подоцна и директор на Државниот завод за индустриска сопственост. Оженет е и татко на две деца. Зборува повеќе странски јазици, особено англиски. Го сака спортот и природата. На локалните избори во 2025 година, последователно, по вторпат, го добил мандатот за градоначалник на Општина Центар.



Komuna QENDËR

Kryetar: GORAN GERASIMOVSKI

Goran Gerasimovski është lindur më 9 janar 1982 në Shkup. Ka diplomuar për sociologji, ndërsa ka magjistruar për menaxhimin e resurseve njerëzore, duke fituar njohuri të avancuara në zhvillimin organizativ dhe menaxhimin e institucioneve publike. Karrierën e tij profesionale e ka filluar në Entin Shtetëror të Statistikës (2006 – 2008), ku ka punuar për përgatitje dhe koordinim të hulumtimeve statistikore. Nga viti 2009 deri në vitin 2017 ka qenë aktiv në sektorin privat, duke udhëhequr projekte të sferës së hulumtimeve publike, analitikes dhe komunikimeve. Në vitin 2017 është emëruar zëvendës-drejtor, ndërsa më pas edhe drejtor i Entit Shtetëror për Pronësi Industriale. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Flet më shumë gjuhë të huaja, sidomos anglisht. E do sportin dhe natyrën. Në zgjedhjet lokale të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, e ka fituar mandatin për kryetar të Komunës Qendër.

Општина ЦЕНТАР ЖУПА

**ПОВЕРЕНИК од ВЛАДА на РСМ:
АРИЈАН ИБРАИМ**

Аријан Ибраим е роден во 1972 година во село Голем Папрадник. Татко му бил печалбар во Швајцарија. Основно образование завршил во Центар Жупа, а средно медицинско во училиштето „Никола Штејн“ во Тетово. Дипломирал како економист на Државниот универзитет во Афјон (Република Турција). Магистрирал на Истанбулскиот универзитет, насока Меѓународно право. Се истакнувал како поборник во образованието на мајчин, турски јазик во Центар Жупа, каде што работел две години. По неколку години печалба во Италија, се вратил и започнал активно да се занимава со политика. За градоначалник на Општина Центар Жупа бил избран во три последователни мандати: 2013 - 2017; 2017- 2021 и 2022 - 2025 година. Со Одлука на Владата на РСМ од 25 ноември 2025 година, назначен е за повереник за вршење на работите од надлежност на градоначалник на Општина Центар Жупа, до изборот на градоначалник на локалните избори што ќе се одржат на 11 јануари 2026 година.

Komuna e QENDRËS ZHUPË

**I BESUAR nga QEVERIA e RMV-së:
ARIJAN IBRAIM**

Arian Ibrahim është lindur në vitin 1972 në fshatin Papradniku i Madh. Babai i tij ka qenë emigrant në Zvicër. Arsimin fillor e ka mbaruar në Qendrën Zhupë ndërsa arsimin e mesëm në shkollën e mesme mjekësore “Nikolla Shtein” në Tetovë. Ka diplomuar si ekonomist në Universitetin Shtetëror në Afion (Republika e Turqisë). Ka magjistruar në Universitetin e Stambollit, drejtimin E drejta ndërkombëtare. Është dalluar si mbështetës i arsimit në gjuhën amtare turke në Qendrën Zhupë, ku ka punuar për dy vjet. Pas disa vitesh punë në Itali është kthyer dhe ka filluar të merret në mënyrë aktive me politikë. Për kryetar të Komunës së Qendrës Zhupë është zgjedhur në tri mandate të njëpasnjëshme: 2013 - 2017, 2017 - 2021 dhe 2022 - 2025. Me Vendimin e Qeverisë së RMV-së nga 25 nëntori i vitit 2025 është emëruar për nëpunës administrativ për të kryer punët e kompetencës së kryetarit të Komunës së Qendrës Zhupë, deri në zgjedhjen e kryetarit të komunës në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 11 janar 2026.

Општина ЧАИР

Градоначалник: ИЗЕТ МЕЦИТИ

Изет Мечити е роден е на 8 февруари 1977 година во Скопје. Средното образование го завршил во гимназијата „Зеф Љуш Марку“ во Скопје. Студирал на Економскиот факултет при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, насока Финансиски менаџмент и сметководство, каде потоа и магистрирал од областа јавен менаџмент. Пред целосно да се вклучи во политиката работел како професор по економија во средното училиште „Арсени Јовков“ во периодот 2001–2003 година. Од 2003 до 2005 година бил назначен за економски советник во Поштата на РМ. Оженет е и има три деца. Од 2005 до 2017 година, последователно во три мандати, населението му ја дало довербата да ја извршува функцијата градоначалник на Општина Чаир. На парламентарните избори во 2020 година бил избран за пратеник во Собранието на РСМ. Во периодот 2024 – 2025 година, бил прв вице-премиер на РСМ и министер за животна средина и просторно планирање. На локалните избори во октомври 2025 година, повторно се кандидира за градоначалник и по четврти пат ја добива градоначалничката функција за Општина Чаир.

Komuna e ÇAIRIT

Kryetar: IZET MEXHITI

Izet Mexhiti është lindur më 8 shkurt 1977 në Shkup. Arsimin e mesëm e ka mbaruar në gjimnazin “Zef Ljush Marku” në Shkup. Ka studiuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në drejtimin Menaxhimi Financiar dhe Kontabiliteti, ku më pas ka magjistruar në fushën e menaxhimit publik. Para se të angazhohej plotësisht në politikë, ka punuar si profesor ekonomie në shkollën e mesme “Arseni Jovkov” në periudhën e viteve 2001–2003. Nga viti 2003 deri në vitin 2005 është emëruar si këshilltar ekonomik në Postën e RM-së. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Nga viti 2005 deri në vitin 2017, në tri mandate radhazi, popullata ia ka dhënë besimin për të ushtruar funksionin e kryetarit të Komunës së Çairit. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 është zgjedhur deputet në Kuvendin e RMV-së. Në periudhën e viteve 2024 – 2025, ka qenë Zëvendës-kryeministër i parë i RMV-së dhe Ministër për Mjedisin Jetësor dhe Planifikimin Hapësinor. Në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2025, sërish kandidohet për kryetar dhe për herë të katërt fiton funksionin e kryetarit të Komunës së Çairit.

Општина ЧАШКА

Градоначалник: СУАТ ШАКИРОВ

Суат Шакиров е роден на 21 октомври 1988 година во село Горно Јаболчиште. На Државниот универзитет во Тетово завршил Правен факултет, правосудна насока. На Универзитетот на Југоисточна Европа, завршил Факултет за политички науки, каде што и магистрирал и се стекнал со звањето магистер по дипломатија, додека докторски студии по кривично право, завршил на Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје. Од 2012 година работел во Секретаријат за имплементација на Охридскиот договор, со фокус на примена на Договорот во државните институции. Во 2014 година станал стручен соработник - правник во Министерството за правда, во подготовка и следење на законските измени и зајакнување на правниот систем. Потоа бил организациски директор на Универзитетската клиника за пулмологија и алергологија во Скопје и бил секретар на Државниот совет за превенција на детско престапништво. Бил член на повеќе работни групи за правни реформи и национални стратегии, како и член на работната група за изработка на стратегија на Министерството за внатрешни работи. Бил автор на анализи/мислења во локални и регионални медиуми. Учествовал на повеќе меѓународни конференции и семинари во земјата и во странство.



Komuna e ÇASHKËS

Kryetar: SUAT SHAQIROV

Suat Shaqirov është lindur më 21 tetor 1988 në fshatin Jabollçisht i Epërm. Në Universitetin Shtetëror të Tetovës ka mbaruar Fakultetin Juridik, drejtimi jurisprudencë. Në Universitetin e Evropës Juglindore ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Politike, ku gjithashtu ka magjistruar dhe ka fituar titullin magjistër për diplomaci, ndërsa studimet e doktoratës në të drejtën penale i ka mbaruar në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Që nga viti 2012 ka punuar në Sekretariatit për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, me fokus në zbatimin e marrëveshjes në institucionet shtetërore. Në vitin 2014 është bërë bashkëpunëtor profesional - jurist në Ministrinë e Drejtësisë, në përgatitjen dhe ndjekjen e ndryshimeve ligjore dhe forcimin e sistemit të drejtësisë. Më pas ka qenë drejtor organizativ në Klinikën Universitare për Pulmologji dhe Alergologji në Shkup dhe ka qenë sekretar i Këshillit Shtetëror për parandalimin e krimeve të fëmijëve. Ka qenë anëtar i disa grupeve punuese për reforma ligjore dhe strategji kombëtare, si dhe anëtar i grupit punues për hartimin e strategjisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ka qenë autor i analizave/mendimeve në media lokale dhe rajonale. Ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe seminare ndërkombëtare në vend dhe jashtë.

Општина ЧЕШИНОВО – ОБЛЕШЕВО

Градоначалник:
ЈОРДАНЧЕ КОСТАДИНОВ

Јорданче Костадинов е роден на 15 јануари 1976 година. Завршил средно економско училиште во Кочани, а дипломирал на Педагошкиот факултет при УКИМ, Скопје, каде што се стекнал со звањето дипломиран професор по одделенска настава. Од 2007 до 2023 година бил наставник во ООУ „Климент Охридски“ во Облешево, каде од јули, 2023 година до октомври 2025 година бил директор на училиштето. Има познавања од англиски јазик. Го сака спортот, природата и спортскиот риболов. Оженет е и татко на две деца. Во периодот од 2005 до 2009 бил избран за член на Советот на Општина Чешиново – Облешево.



Komuna ÇESHINOVË – OBLESHEVË

Kryetar:
JORDANÇE KOSTADINOV

Jordançe Kostadinov është lindur më 15 janar 1976. Ka mbaruar shkollën e mesme ekonomike në Koçan, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup, ku ka fituar titullin profesor i diplomuar për mësimdhënien e klasave. Nga viti 2007 deri në vitin 2023 ka qenë mësues në SHFK “Klimenti i Ohrit” në Obleshevë, ku nga korriku i vitit 2023 deri në tetor të vitit 2025 ka qenë drejtor i shkollës. Ka njohuri të gjuhës angleze. E do sportin, natyrën dhe peshkimin sportiv. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2009 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës Çeshinovë – Obleshevë.

Општина ШТИП

Градоначалник: ИВАН ЈОРДАНОВ

Иван Јорданов е роден на 21 јули 1988 година во Ново Село, Штип. Дипломирал во 2010 година на Економскиот факултет, на Универзитет „Гоце Делчев“ – Штип, отсек Меѓународна економија. Со звањето магистер по менаџмент на човечки ресурси се стекнал на Меѓународниот славјански универзитет „Гаврило Романович Державин“. Во 2014 година се вработил во Управата за јавни приходи – Штип, како асистент за утврдување на данок на физички лица и како асистент за поврат, пребивање и насочување на данок. Зборува добро англиски јазик. Оженет е и татко на едно дете. Од 2013 до 2020 година бил член на Советот на Општина Штип, а потоа на парламентарните избори во 2020 година бил избран за пратеник во Собранието на РСМ до октомври 2021 година. Таму учествувал во работата на повеќе комисији меѓу кои: за локална самоуправа; за финансирање и буџет и за економија и бил член на повеќе интерпарламентарни групи. На локалните избори во октомври 2025 година, последователно, по вторпат, бил избран за градоначалник на Општина Штип.



Komuna e SHTIPIT

Kryetar: IVAN JORDANOV

Ivan Jordanov është lindur më 21 korrik 1988 në Novo Sellë, Shtip. Ka diplomuar në vitin 2010 në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin “Goce Dellçev” - Shkup, dega Ekonomi Ndërkombëtare. Titullin magjistër për menaxhimin e resurseve njerëzore ka fituar në Universitetin Ndërkombëtar Sllavjan “Gavril Romanoviç Derzhavin”. Në vitin 2014 është punësuar në Drejtorinë e të Hyrave Publike - Shtip, si asistent për përcaktimin e tatimit për persona fizikë dhe si asistent për kthimin, qëndrimin dhe orientimin e tatimit. Flet mirë gjuhën angleze. Është i martuar dhe baba i një fëmije. Nga viti 2013 deri në vitin 2020 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Shtipit, ndërsa më pas në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 është zgjedhur deputet në Kuvendin e RMV-së deri në tetor të vitit 2021. Atje ka marrë pjesë në punën e disa komisioneve, duke përfshirë atë: për vetëqeverisjen lokale; për financimin dhe buxhetin dhe për ekonomi, dhe ka qenë anëtar i disa grupeve ndërparlamentare. Në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2025, për herë të dytë radhazi, është zgjedhur për kryetar të Komunës së Shtipit.

Општина ШУТО ОРИЗАРИ

Градоначалник: КУРТО ДУДУШ

Курто Дудуш е роден на 7 декември 1974 година. Дипломирал на Универзитетот за економија и менаџмент, Скопје. Во периодот од 1995 до 2000 година работел во Мајнхајм, Германија, како менаџер на корпорацијата „Виледа“, а потоа во периодот од 2001 до 2016 бил директор на сопствена компанија, со седиште во Шуто Оризари. Зборува германски, англиски и српски јазик. На парламентарните избори во 2016 година бил избран за пратеник во Собранието на РМ, каде учествувал во креирање на развојни политики за подобрување на животниот стандард на Ромите во земјата. Во 2017 година на локалните избори се кандидирал за градоначалник на Општина Шуто Оризари и жителите, од тогаш до сега, последователно, по третпат, му ја даваат довербата за вршење на градоначалничката функција.





Komuna e SHUTO ORIZARES

Kryetar: KURTO DUDUSH

Kurto Dudush është lindur më 7 dhjetor 1974. Ka diplomuar në Universitetin për ekonomi dhe menaxhment në Shkup. Në periudhën nga viti 1995 deri në vitin 2000 ka punuar në Mejnhaјm të Gjermanisë si menaxher në korporatën “Vileda”, ndërsa më pas në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2016 ka qenë drejtor i kompanisë së tij me seli në Shuto Orizare. Flet gjuhën gjermane, angleze dhe serbe. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 është zgjedhur deputet në Kuvendin e RM-së, ku ka marrë pjesë në krijimin e politikave zhvillimore për përmirësimin e standardit jetësor të Romëve në vend. Në vitin 2017 kandidohet në zgjedhjet lokale për kryetar të Komunës së Shuto Orizares dhe banorët, prej atëherë e deri më sot, për herë të tretë radhazi, ia japin besimin për të ushtruar funksionin e kryetarit të komunës.

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ

тел. +389 (0) 2 30 99 033

ул. „Копенхагенска“ бр. 5, п.фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија

contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

INFORMACIONE PËR KONTAKT

tel. +389 (0) 2 30 99 033

rr. Kopenhagenska nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk